

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5582  
E premte, 21 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

## Kuvendi miraton marrëveshjet me BE-në

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**VETERANËT MASHTRUES, VETERANËT E VËRTETË DHE HIENAT KUNDËR LUFTËS ÇLIRIMTARE!** F. 11

Behxhet  
Sh. SHALA -  
BAJGORA



**DASH-I: KOSOVA VAZHDON T'I KUNDËRVIHET KËRCËNIMIT TË TERRORIZMIT** F. 2

**POLICIA ARRESTON 22 PERSONA TË DYSHUAR PËR PROSTITUCION** F. 6

### EKONOMI

**MINISTRI LLUKA: LIGJI PËR INVESTIMET STRATEGJIKE GARANTON INVESTIMET E HUAJA** F. 8

**RRITET MUNDËSIA E KREDITIMIT PËR BIZNESET NË KOSOVË** F. 8

### KULTURË

**MKRS-ja, STRATEGJI PËR PARANDALIMIN E DUKURIVE NEGATIVE NGA TË RINJTË** F. 6

### SPORT

**FERONIKELI, GATI TA ZBRESË NGA FRONI FLAMURTARIN** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", MAZLLUM BARALIU | FAQE 4-5

## As pozita e as opozita nuk janë në nivel të detyrës

Njohësi i proceseve politike në vend, Mazlum Baraliu, ka kritikuar pozitën dhe opozitën për mosefikasitetin e Kuvendit të Kosovës për çështje të rëndësishme kombëtare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se asnjëra palë nuk është në krye të detyrës dhe përgjegjësisë që kanë. Baraliu e ka ftuar pozitën dhe opozitën t'i kthehen gjuhës së konsensusit, sidomos për çështjen e dialogut me Serbinë. Ai ka shprehur skepticizëm se mund të gjendet një konsensus për këtë çështje, duke shtuar se praktika e deritashme ka treguar se kjo klasë politike nuk mund t'i kalojë interesat e ngushta. Sipas Baraliut, nëse kjo nuk arrihet, alternativë e vetme mbesin zgjedhjet e reja

## Fehmi dhe Xhevë Lladrovci i kthehen Drenicës në bronz

Njëzet vjet pas rënies së tyre heroike, Fehmi Lladrovci dhe Xhevë Krasniqi-Lladrovci i janë kthyer Drenicës në bronz, në sheshin kryesor të qytetit të Drenasit. Zbulimi i shtatoreve të tyre është bërë mesditën e së enjtes në një manifestim përkujtimor në të cilin kanë marrë pjesë liderë nga të gjitha trojet shqiptare. Me këtë rast të pranishmit kanë vlerësuar lart veprimtarinë dhe heroizmin e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci | FAQE 7



**Thaçi: Kosova duhet t'i mbështesë kërkesat e Luginës së Preshevës**

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Basha: Vendi në emergjencë kombëtare

TIRANË, 20 SHTATOR - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha deklaroi nga Vlora se vendi ndodhet në emergjencë kombëtare. Sipas tij, në vend nuk ka më gjykata dhe as prokurorë për të gjykuar bandat. Për sa i përket çështjes së Teatrit, ai theksoi se ai nuk është gjë tjetër veçse ligji "Fusha" për grabitjen e Teatrit. Veç kësaj, Basha shtoi se Rama nuk e do 'vettin-gun' në politikë.

Në krah të Bashës ndodhej kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi dhe kreu i PDIU-së

Shpëtim Idrizi.

"Ndërsa ne jemi mbledhur në këtë sallë, në sallën e Kuvendit të Shqipërisë një mazhorancë e korruptuar dhe inkriminuar deri në palcë po ndërmer një akt të paprecedentë në historinë 300-vjeçare të Evropës. Edi Rama, hajdutët dhe kriminelët e tij në Parlament bashkë me një luftë delesh u kapën flagrant në aktin e vjedhjes përmes procedurës së përsheptuar dhe ligjit special Rama-Fusha për grabitjen e pronës publike dhe Teatrit Kombëtar.

Ata kanë si qëllim që së bashku me mafien e drogës dhe përfaqësuesit e tyre në industrinë e ndërtimit të ngrinin 7 kulla me një vlerë 200 milionë eurosh. Nga Uashingtoni në Bruksel nuk ka njeri që se kupton më që Edi Rama është hajdut me damkë, qëllimi i vetëm i të cilit është të mbahet pas karriges për të zhvatur edhe centin e fundit dhe pasurinë e fundit publike të shqiptarëve", deklaroi Basha. Opozita e bashkuar ka zgjedhur Vlorën dhe jo Parlamentin, sipas tyre për të qëndruar atje ku



njerëzit janë të rrezikuar dhe të pasigurt nga bandat dhe jo në godinën ku bandat përfaqësohen nga qeveria.

## DASH: Kosova vazhdon t'i kundërvihet kërcënimit të terrorizmit

Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin vjetor për terrorizmin në botë për vitin 2017

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kosova vazhdoi t'i kundërvihet kërcënimit gjithnjë në rritje të terrorizmit në vitin 2017, thuhet në raportin vjetor të Departamentit Amerikan të Shtetit për terrorizmin në botë në vitin 2017. Ky raport thekson se rreth 403 qytetarë të Kosovës kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për t'iu bashkuar grupit militant Shteti Islamik apo Frontit al-Nusrah, prej të cilëve rreth 74 kanë vdekur. "Rreth 133 prej këtyre individëve janë kthyer, ndërsa rreth 196 mbeten në këto zona konfliktit. Ky numër përfshin 40 fëmijë të lindur nga qytetarë të Kosovës në zonat e konfliktit", theksohet në raport. Gjendja e sigurisë dhe ajo politike në veriun e Kosovës, thuhet tutje, ka vazhduar ta kufizojë aftësinë e qeverisë për ta ushtruar autoritetin e saj në atë rajon, megjithëse Qeveria ka integruar me sukses gjyqtarët,

prokurorët dhe stafin serb në institucionet gjyqësore të Kosovës në tetor, duke zgjeruar autoritetin gjyqësor të vendit dhe qasjen në drejtësi për qytetarët.

Raporti nënvizon se kuadri ligjor i Kosovës është i mjaftueshëm për të ndjekur penalisht individë të dyshuar për kryerjen ose mbështetjen e aktiviteteve terroriste, porse prokurorët nuk kanë përvojë në raste të tilla.

Gjatë vitit 2017, thuhet në raport, Qeveria e Kosovës ndërmoi hapa aktivë për të përgatitur një strategji riatdhesimi për qytetarët e saj që ktheheshin nga zonat e konfliktit. Po në këtë raport jepet vlerësimi edhe për Shqipërinë.

Në raport thuhet se gjatë vitit 2017 Shqipëria ishte një mbështetëse e fuqishme e përpjekjeve kundër terrorizmit dhe vazhdoi pjesëmarrjen e saj në Aleancën Globale për ta mposhtur ISIS-in.

Shqipëria, thuhet në raport,



penalizon veprimet terroriste, financimin e terrorizmit, kryerjen e transakcioneve me persona që janë në listat e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, rekrutimin dhe trajnimin e njerëzve për kryerjen e veprave terroriste, nxitjen e akteve terroriste dhe krijimin apo pjesëmarrjen në organizata terroriste.

Në raport thuhet se gjatë vitit 2017 forcat e rendit në Shqipëri i shtuan përpjekjet për t'i luftuar kërcënimet e mundshme terroriste. Korrupsioni dhe pengesat ndaj shkëmbimit të informacionit midis agjencive qeveritare, koordinimi i pamjaftueshëm brenda agjencive dhe një sistem gjyqësor që funksionon dobët,

thotë raporti, vazhdoi t'i pengonte përpjekjet e zbatimit të ligjit në të gjitha nivelet. Në raport thuhet se në vend po bëhen reforma kushtetuese dhe ligjore për gjyqësorin, duke filluar me verifikimin e 800 gjyqtarëve dhe prokurorëve për korrupsion apo lidhje me krimin e organizuar si dhe për aftësitë e tyre profesionale.

## Kotzias: Ja pse ngeci marrëveshja me Shqipërinë

ATHINË, 20 SHTATOR - Edhe pse kaloi nga Tirana dhe u takua me kryeministrin Edi Rama dhe homologun e tij shqiptar, Ditmir Bushati, ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas ka folur përsëri për Shqipërinë në Athinë.

"Biseduam për marrëveshjen e Prespës dhe për negociatat me Shqipërinë", ka theksuar kreu i diplomacisë greke, Nikos Kotzias në konferencën me gazetarë, duke dhënë dhe një shpjegim se përse po vonohet marrëveshja

me Tiranën zyrtare.

"Siç jeni në dijeni, negociuam me Shqipërinë dhe negociatat nuk kanë ngecur as te ne dhe as te Ministria e tyre e Jashtëm, por te problemet administrative që kanë, mosmarrëveshjet e presidentit me qeverinë. Dhe te fakti që gjykata konfirmuese, Gjykata Kushtetuese, nuk është aktualisht e plotë në këtë moment, as të paktën në funksionin e nevojshëm", shpjegoi Kotzias.

Gjithashtu, kreu i diplomacisë

greke i është referuar edhe referendumit në IRJM duke pasqyruar mbështetjen që po merr qeveria Zaev nga të gjithë liderët evropianë. "Ne mbështesim Marrëveshjen e Prespës. Vlerësojmë atë që kam thënë edhe herët e tjera dhe nuk lodhem ta them se historia duhet të jetë shkollë dhe jo burg. Kjo marrëveshje na nxori nga burgju. Disa ëndërojnë që të hyjnë përsëri brenda. Nuk do t'i ndjekim pas", tha Kotzias.





Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancën plenare të radhës

# Kuvendi miraton marrëveshjet me BE-në

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të enjten Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe BE-së, Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët", si dhe Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +". Shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Natalya Apostolova, ka mirëpritur votimin e tri projektligjeve nga Kuvendi i Kosovës, duke theksuar se vota për këto projektligje konfirmon përkatësinë evropiane të Kosovës



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar të enjten tri marrëveshje ndërkombëtare që lidhen me bashkëpunimin ndërmjet Kosovës me Bashkimin Evropian (BE). Marrëveshjet e miratuara nga Kuvendi janë: Marrëveshja Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët"; dhe Marrëveshja ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +" Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport. Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se votimi i projektligjeve që lidhen

me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare i japin shtytje vendit tonë në shumë fusha, duke kontribuar për procesin integruar. "Andaj i falënderoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për votim. Me miratimin e këtyre marrëveshjeve ne vendim tonë e bëjmë gati për integrim. Të drejtat e njeriut, eficientia e energjisë, ekonomia digjitale, siguria ushqimore, lidhshmëria e arsimit me tregun e punës dhe politikatat sociale janë fusha ku do të përdoren fondet e marrëveshjes së parë, ku vlera arrin në 48 milionë euro, përkrahje nga BE-ja për Kosovën", ka thënë Hoxha. Ajo ka shtuar se programi "Evropa për qytetarët" përban fonde prej 187 milionë eurosh që synon ta promovojë qytetarinë aktive evropiane dhe si fokus ka autoritetet lokale, organizatat hulumtuese të politikave, grupet e qyte-

tarëve dhe organizatat e shoqërisë civile. "Kosova, po ashtu, me Programin Erasmus+ bëhet vend partner i BE-së dhe përfiton nga rrjetet e ndryshme të mbështetjes së politikave evropiane siç janë Korniza Evropiane e Kualifikimeve, Eurydice, Europass dhe Euroguidance dhe platformat elektronike (Twinning dhe EPALE). Kosova kështu bëhet e barabartë me fqinjët e Ballkanit Perëndimor si dhe me vendet

anëtare të BE-së për rrjetet mbështetëse të politikave, duke fuqizuar perspektivën evropiane dhe të ardhmes drejt BE-së", ka thënë ministrja Hoxha. Shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Natalya Apostolova, ka mirëpritur votimin e tri projektligjeve nga Kuvendi i Kosovës të cilat lidhen me marrëveshjet në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Apostolova përmes një postimi në llogarinë e vet "Twitter" ka

shkruar se votimi i këtyre ligjeve konfirmon përkatësinë evropiane të Kosovës. "Përgëzoj Kuvendin e Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes IPA 2017 dhe pjesëmarrjen në programet Erasmus+, Evropa Kreative dhe Evropa për Qytetarët. Vota konfirmon përkatësinë evropiane të Kosovës dhe aftësinë për t'u bashkuar rreth çështjeve me interes kombëtar", ka shkruar Apostolova.

## Thaçi: Kosova duhet t'i mbështesë kërkesat e Luginës së Preshevës

PRISHTINË, 20 SHTATOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të enjten se shteti ynë duhet t'i mbështesë me veprime konkrete kërkesat e shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. "Unë i përgjigjem pozitivisht çdo mundësi për nënshkrimin e një marrëveshjeje me shkrim me përfaqësuesit politikë e legjitimë të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën. Gjatë tërë kësaj kohe kam kërkuar unitet politik në Kosovë për përkrahjen e kërkesës së tyre dhe dëshiroj që, pas nënshkrimit tim, të gjitha subjektet politike parlamentare që u ka shkruar ajo kërkesë, t'i radhisin nënshkrimet si zotim për miratimin e rezolutës së iniciuar prej përfaqësuesve politikë të Luginës së Preshevës, për

bashkim me Kosovën", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Po ashtu, presidenti Thaçi në një konferencë për medie gjatë kësaj jave ka kritikuar zërat që pretendojnë se korrigjimi i kufirit Kosovë - Serbi në kuadër të marrëveshjes përfundimtare do ta destabilizojë rajonin. Ai ka thënë se këta zëra janë të paqëndrueshëm dhe vetëm po mundohen të shpërndajnë mjegull. Shefi i shtetit ka deklaruar se marrëveshja përfundimtare i siguron Kosovës njohjen formale nga Serbia, bashkëngjitjen e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit në territorin e Kosovës si dhe i hap rrugë të sigurt Kosovës drejt anëtarësimit në NATO, Bashkimin Evropian dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara.





Flet për "Epokën e re", Mazllum Baraliu

# As pozita e as opozita nul



Njohësi i proceseve politike në vend, Mazllum Baraliu, ka kritikuar pozitën dhe opozitën për mosefikasitetin e Kuvendit të Kosovës për çështje të rëndësisë kombëtare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se asnjëra palë nuk është në krye të detyrës dhe përgjegjësisë që kanë. Baraliu e ka ftuar pozitën dhe opozitën t'i kthehen gjuhës së konsensusit, sidomos për çështjen e dialogut me Serbinë. Ai ka shprehur skepticizëm se mund të gjendet një konsensus për këtë çështje, duke shtuar se praktika e deritashme ka treguar se kjo klasë politike nuk mund t'i kalojë interesat e ngushta. Sipas Baraliut, nëse kjo nuk arrihet, alternativë e vetme mbesin zgjedhjet e reja

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 20 SHTATOR** - Njohësi i proceseve politike në vend, Mazllum Baraliu, ka fajësuar pozitën dhe opozitën për gjendjen krijuar në Kuvendin e Kosovës. Ai ka deklaruar se asnjëra palë nuk është në krye të detyrës dhe përgjegjësisë që ka. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", Baraliu ka thënë se mënyra e punës së kësaj legjislature me bllokime e bojkote është e papranueshme. "Fatkeqësisht, as pozita dhe as opozita nuk janë në nivel të detyrës dhe përgjegjësisë që kanë, qoftë në relacion me votuesit e tyre dhe me institucionin që i përkasin, si dhe me mandatin që kanë marrë. Prandaj, një gjë e tillë është e

papranueshme. Kjo mënyrë e punës së kësaj legjislature është diçka që nuk do të duhej të ndodhte", ka thënë Baraliu. Ai e ka ftuar pozitën dhe opozitën që sa më shpejt t'i kthehen gjuhës së konsensusit dhe të arrijnë pajtueshmëri për disa çështje. Megjithatë, Baraliu ka shprehur skepticizëm se kjo klasë politike do të mund të gjejë gjuhë të përbashkët për fazën finale të dia-

logut me Serbinë. "Në bazë të përvojës së deritashme që kemi pasur, nuk mund të konkludojmë se kjo klasë politike dhe këto institucione do ta gjejnë fuqinë, energjinë dhe vullnetin e tyre për të arritur konsensus. Asnjëherë deri më tani në krizat që kaluam para VLAN-it, pas VLAN-it dhe më vonë nuk pati vullnet dhe fuqi kjo klasë politike të ngrihet në nivel të detyrës dhe ta tejkalojë vetveten në mënyrë që të ketë konsensus për çështjet që i përmenda më sipër", është shprehur ai, duke shtuar se Kosova nuk duhet të shkojë në dialog me Serbinë pa pasur një konsensus në mes të subjekteve politike për këtë çështje. Sipas tij, nëse partitë politike nuk arrijnë ta ndërtojnë një konsensus për këtë çështje, alternativë e vetme mbesin zgjedhjet e reja. "Nëse nuk do të gjendet një pajtim mes subjek-

teve politike për dialog dhe për çështje të tjera kombëtare, patjetër se duhet të shikohet mundësia e mocionit të mosbesimit për ta rrëzuar Qeverinë. Nuk ka zgjidhje tjetër pos hapjes së rrugës për zgjedhje të reja, ku do të bëhet verifikimi edhe një herë i cilido subjekt politik", është shprehur Baraliu, duke shtuar se zgjedhjet e reja do ta sjellin krijimin e një legjitimiteti dhe legaliteti të ri.

**"Epoka e re":** Z. Baraliu, Kuvendi i Kosovës ka nisur sesionin vjeshtor të punës, por nuk po arrin ta kryejë funksionin si duhet. Ai po has në pengim të punimeve nga pozita dhe opozita. Cili është komenti juaj rreth kësaj gjendje?

**Baraliu:** Që një kohë relativisht të gjatë, të paktën nga prilli i këtij viti, Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë legjislativ, në një formë



# ku janë në nivel të detyrës

Tash së fundi kemi pasur reagim të shifes së Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, e cila thotë se me këtë mënyrë të luftës politike në mes të subjekteve politike të ashpërsuar deri në animozitet, Kuvendi nuk po arrin ta përmbushë funksionin e vet kushtetues.

**"Epoka e re":** Kuvendi ka ngecur në një situatë ku nuk po mund të marrë ndonjë vendim në lidhje me fazën finale të dialogut me Serbinë. Pozita nuk po mund ta bëjë kuorumin për votimin e ekipit negociator për bisedime, kurse opozita nuk po mund të krijojë kuorum për miratimin e një rezolute për këtë fazë të dialogut. Si mund të tejkalohet kjo situatë?

**Baraliu:** Fatkeqësisht, as pozita dhe as opozita nuk janë në nivel të detyrës dhe përgjegjësisë që kanë, qoftë në relacion me votuesit e tyre dhe me institucionin që i përkasin, si dhe me mandatin që kanë marrë. Prandaj, një gjë e tillë është e papranueshme. Kjo mënyrë e punës së kësaj legjislature është diçka që nuk do të duhej të ndodhte. Së pari, çështjet prioritare legjislative do të duhej të votoheshin dhe pjesëmarrja e subjekteve politike në seanca do të duhej të ishte veçanërisht kur kemi të bëjmë me votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i sjellin Kosovës miliona euro. Kjo gjendje është e rëndë, është një bllokim dhe një ngecje që nuk mund t'i përshkruhet vetëm pozitës apo vetëm opozitës. Ekipi negociator dhe platforma politike janë çështje me interes kombëtar dhe në këtë drejtim do të duhej të gjendej një konsensus.

**"Epoka e re":** Si ngjarje urgjente tani po shihet konsensusi kombëtar për çështjen e bisedimeve me Serbinë. Do të mund ta tejkalojnë vetveten këto subjekte politike për të arritur një konsensus të tillë?

**Baraliu:** Në bazë të përvojës së deritashme që kemi pasur, nuk mund të konkludojmë se kjo klasë politike dhe këto institucione do të gjejnë fuqinë, energjinë dhe vullnetin e tyre për të arritur konsensus. Asnjëherë deri më tani në krizat që kaluam para VLAN-it, pas VLAN-it dhe më vonë nuk pati vullnet dhe fuqi kjo klasë politike të ngrihet në nivel të detyrës dhe ta tejkalojë vetveten në mënyrë që të ketë konsensus për çështjet që i përmenda më sipër. Duke u bazuar në këtë, unë shpreh dyshimin tim se mund të bëhet diçka. Madje kemi parë se edhe brenda pozitës dhe opozitës kemi qëndrime të

ndryshme. Në këtë mënyrë kjo klasë politike nuk është në gjendje t'i tejkalojë dallimet dhe të merret vesh për një platformë e cila do të sillte konsensus.

**"Epoka e re":** A duhet të shkojë Kosova në dialog pa një platformë dhe ekip negociator të miratuar në Kuvend?

**Baraliu:** Nuk duhet të shkohet në bisedime pa një platformë dhe pa përgatitje, pa marrë parasysh ingerencat kushtetuese. Është koha e fundit e vetëdijesimit të kësaj klase politike që në Kuvend të merren vesh për këto çështje. Po ashtu, Kosova nuk ka nevojë të ngutet për dialog me Serbinë. Do të duhej që të ketë durim, të bëhet punë dhe të arrihet një marrëveshje konsensuale para

se dikush të shkojë atje për interesa të Serbisë, apo qarqeve të caktuara të Bashkimit Evropian, i cili është në një situatë krize. Ne duhet të përgatitemi dhe të jemi të unifikuar si klasë politike në këtë proces. Përndryshe, mund të bëhen gabime edhe më të mëdha sesa këto që janë bërë gjatë këtyre viteve.

**"Epoka e re":** Nëse kjo klasë politike nuk do të arrijë t'i tejkalojë inatet dhe të gjejë një konsensus për çështje kombëtare, si duhet të veprohet? Zgjedhjet, a janë alternativë?

**Baraliu:** Nëse nuk do të gjendet një pajtim mes subjekteve politike për dialog dhe për çështje tjera kombëtare, patjetër se

duhet të shikohet mundësia e mocionit të mosbesimit për ta rrëzuar Qeverinë. Nuk ka zgjidhje tjetër pos hapjes së rrugës për zgjedhje të reja, ku do të bëhet verifikimi edhe një herë i cilido subjekt politik. Zgjedhjet e reja do ta sjellin krijimin e një legjitimiteti dhe legaliteti të ri, pra do të kemi një strukturë të re qeverisëse e cila, ndoshta, do ta menaxhonte më mirë ardhmërinë e këtij shteti dhe konsolidimin e tij. Kështu si po ecët, nuk ka kuptim. Kjo klasë politike duhet të kuptojë se kështu më nuk bën të vazhdohet. Kosova më tepër se kurdoherë ka nevojë ta përdorë dhe të aplikojë fjalën unifikim në mënyrë që të tejkalohet kjo gjendje e krizës politike.

## Kosova dhe Komisioni Evropian diskutojnë për zbatimin e agjendës evropiane

Prishtinë, 19 shtator (ER) - Autoritetet e Kosovës dhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian kanë mbajtur takimin e nënkomisionit të dytë të MSA-së për ekonomi, çështje financiare dhe statistika në Prishtinë. Takimi është përqendruar në ekonomi, çështje financiare, statistika dhe kontrollin financiar. Diskutimi është zhvilluar në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), e cila ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016.

Në të gjitha fushat, Komisioni dhe Kosova u pajtuan për rëndësinë e zbatimit të Agjendës të

Reformave Evropiane dhe prioriteteve të Programit të Reformave Ekonomike si dhe rekomandimeve nga Raporti i Komisionit për Kosovën. Përfaqësuesit e Komisionit dhe të Qeverisë së Kosovës diskutuan një numër fushash të politikave, duke përfshirë zhvillimin makroekonomik të Kosovës, politikat fiskale dhe financiare, reformat strukturore dhe zhvillimin e sektorit privat, sistemin statistikor dhe kontrollin financiar. Fillimisht, përfaqësuesit e Komisionit Evropian theksuan rëndësinë e zbatimit të kon-

kluzioneve të përbashkëta të miratuara së fundmi për Programet e Reformës Ekonomike 2018-2020.

Në fushën e politikave ekonomike dhe fiskale u diskutuan zhvillimet kryesore ekonomike, duke përfshirë rritjen e BPV-së, inflacionin, tregun e punës dhe konkurrencën e jashtme. Takimi u bashkëkryesua nga Ministria për Integritet Evropian dhe drejtoritë e përgjithshme të Komisionit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Financiare dhe ajo për Fqinjësi dhe Nogociata të Zgjerimit.



apo në një tjetër është joefikas, i bllokuar, i bojkotuar dhe jo sa duhet produktiv. Pra, ky institucion nuk po mund t'i kryejë detyrat që dalin nga plani legjislativ i tij për këtë vit kalendarik. KDI-ja si monitorues i punës së Kuvendit ka konstatuar se opozita i ka bojkotuar rreth 20 për qind të votimeve gjatë seancave të ndryshme, kurse vetë pozita i ka bojkotuar rreth 19 për qind të votimeve të seancave. Aty ku duhet, sipas legjislacionit në fuqi, që Kuvendi të vendosë me dy të tretat e votave të deputetëve, thjesht Kuvendi është i bllokuar pothuajse në tërësi gjatë gjithë kësaj legjislature. Prandaj, marrë në tërësi, Kuvendi nuk ka arritur t'i përmbushë obligimet e veta dhe, si rrjedhojë, Kosova nuk ka arritur t'i përmbushë obligimet e veta ndaj BE-së. Ndaj këtyre veprimeve edhe BE-ja është e shqetësuar.



## Qendra e Studentëve sot publikon rezultatet e pranimit në konvikte

PRISHTINË, 20 SHTATOR (ER) - Qendra e Studentëve e UP "Hasan Prishtina" në Prishtinë sot (e premte) do t'i shpallë rezultatet për pranimin e studentëve në konvikte për vitin akademik 2018/2019. Kjo është bërë me dije nëpërmjet një komunikate për media nga Zyra për Informim e Qendrës së Studentëve. Në komunikatë është thënë se

konkursi ishte i hapur nga data 4 deri më 13 shtator. Gjatë këtij afati kohor për strehim në konvikte dhe për ushqim në mensë kanë aplikuar 7 100 studentë. "Kapaciteti për banim në konvikte është rreth 4 000, ndërsa për studentët e sektorit privat kapaciteti i shujtave për mensë është 1 500. Afati për ankesa eventuale është më 24 dhe 25

shtator 2018", thuhet në komunikatë. Paraqitja e ankesave do të bëhet përmes sistemit online në adresat zyrtare në uebfaqen [qs.rks.gov.net](http://qs.rks.gov.net) dhe përmes profil-it zyrtar në "Facebook" Qendra e Studentëve - Prishtinë. Gjatë procesit të ankesave nuk pranohen dokumente shtesë. Shqyrtimi i ankesave do të bëhet nga Komisioni për Ankesa.



## MKRS-ja, strategji për parandalimin e dukurive negative nga të rinjtë

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në konferencën "Siguria njerëzore, problemi dhe reagimi institucional" ka prezantuar politikën e kësaj ministrie për sigurinë njerëzore të të rinjve në Kosovë, konkretisht për strategjinë e re kombëtare për rini 2018-2022

konkretisht për strategjinë e re kombëtare për rini 2018-2022. Ai ka thënë se këtë strategji Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka hartuar me qëllim të parandalimit të përhapjes së dukurive negative të cilat cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e rinisë.

Ministri Gashi ka folur rreth transparencës dhe llogaridhënies së punës së shoqërive civile, përkatësisht organizatave dhe qendrave rinore të komunave të Kosovës me të cilat janë bërë marrëveshje të kontraktura. "Ne sot do ta vlerësojmë punën dhe angazhimin, rekomandimet që kanë dalë nga qin-

dra e mijëra të rinj anembanë Kosovës përmes projekteve të mbështetura nga MKRS-ja", ka deklaruar ministri Gashi, duke shtuar se ngjarjet e tilla si fushata në TV, radiodebatet, tryezat e diskutimit në komuna të ndryshme, shpërndarja e materialeve të shtypura dhe prezantimi i tyre në rrjetet sociale dhe mediet elektronike, ka parë që kanë pasur efekt të drejtpërdrejtë për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit në përgjithësi. Ai ka thënë se qëllimi i tij si ministër është të krijohet një mjedis i sigurt për të rinjtë. "Përpos familjes si bërthamë e rëndë-

sishme e funksionimit të duhur të sistemit shoqëror, në kohët e sotme një pjesë bukur e madhe e barrës bie edhe mbi organizatat e shoqërisë civile, sidomos të organizatave rinore. Për këtë qëllim MKRS-ja do t'i mbështesë ato dhe nismat e ndryshme që merren me promovimin e mjedisit të sigurt përmes granteve në baza vjetore. Mbështetja nuk do të kufizohet vetëm në ndërgjegjësim për rëndësinë e të pasurit një mjedis të sigurt brenda Kosovës, por edhe për nismat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare", ka thënë ministri Gashi.

**EPOKA ERE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes Departamentit të Rinisë ka mbajtur të enjten konferencën "Siguria njerëzore, problemi dhe reagimi institucional". Në këtë konferencë u fol mbi rëndësinë e rolit të

shoqërisë civile për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, trafikimit të qenieve njerëzore, delikuencës së të miturve, sfida dhe reagimit institucional. Me këtë rast ministri Kujtim Gashi ka prezantuar politikën e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit për sigurinë njerëzore të të rinjve në Kosovë,

## Policia arreston 22 persona të dyshuar për prostitucion

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Policia e Kosovës ka njoftuar përmes një komunikate për media se ka arrestuar 22 persona të dyshuar për përfshirje në vepra të kundërligjshme, të cilat lidhen me prostitucion. Sipas komunikatës, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe njësitet përkatëse kanë kryer disa operacione në Prishtinë dhe Gjakovë.

Në Prishtinë janë arrestuar 12 persona për vepra të kundërligjshme, konkretisht "mundësim ose detyrim në prostitucion", kurse katër të tjerë janë ndaluar nën dyshimet për kryerje të veprave penale, "mundësim ose detyrim në prostitucion", "ofrim i lokalit për prostitucion" dhe "marrje me prostitucion".

Në rajonin e Gjakovës pjesëtarë të policisë kanë arrestuar gjashtë persona nën dyshimin se kanë mundësuar apo detyruar kryerje të prostitucionit. Në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit është thënë se gjatë vitit 2017 institucionet e Kosovës kanë identifikuar 32 viktima të trafikimit, përkatësisht 25 gra dhe tre meshkuj.





Në 20-vjetorin e rënies së tyre janë vendosur shtatoret e heronjve të kombit Fehmi Lladrovci dhe Xhevë Krasniqi-Lladrovci në sheshin kryesor të Drenasit

# Fehmi dhe Xhevë Lladrovci i kthehen Drenicës në bronz

Njëzet vjet pas rënies së tyre heroike, Fehmi Lladrovci dhe Xhevë Krasniqi-Lladrovci i janë kthyer Drenicës në bronz, në sheshin kryesor të qytetit të Drenasit. Zbulimi i shtatoreve të tyre është bërë mesditën e së enjtes në një manifestim përkujtimor në të cilin kanë marrë pjesë liderë nga të gjitha trojet shqiptare. Me këtë rast të pranishmit kanë vlerësuar lart veprimtarinë dhe heroizmin e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci

EPOKA  
ERE Shqipe HETEMI

DRENAS, 20 SHTATOR - Nën përkujdesjen e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten në Drenas është bërë përvurimi i shtatoreve të heroit Fehmi Lladrovci dhe heroinës Xhevë Krasniqi-Lladrovci. Në manifestimin përkujtimor të mbajtur me rastin e 20-vjetorit të rënies së tyre kanë marrë pjesë liderët shtetërorë të Kosovës, të Shqipërisë, përfaqësuesit e shqiptarëve në Maqedoni si dhe përfaqësuesit e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Me këtë rast presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se kjo është një ditë e veçantë për Kosovën dhe kombin shqiptar. Ai ka theksuar se Xheva dhe Fehmiu do të mbeten në përjetësi emblema të UÇK-së. "Fryma, angazhimi dhe mesazhet unifikuese dhe mobilizuese të Xhevës dhe Fehmiut për UÇK-në, për të gjithë shqiptarët në Kosovë dhe kudo, janë të pakrahasueshëm", ka deklaruar Thaçi. Ai ka vlerësuar se emri, jeta dhe vepra e Xhevës dhe Fehmiut janë, përmenden dhe respektohen kudo që jetojnë shqiptarët. Thaçi ka theksuar se kontributi dhe lufta e Xhevës dhe Fehmiut nuk ishte vetëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës sepse, sipas Thaçit, është e pamjaftueshme të jemi vetëm të lirë dhe të pavarur meqë duhet të integrohemi në NATO dhe BE. "Institucionet e Kosovës janë në rrugë të mbarë, të rregullt, në koordinim edhe me ShBA-në dhe NATO-n, që në muajt e ardhshëm t'i themelojmë edhe Forcat e Armatosura të Kosovës dhe ta fillojmë procesin e partneritetit për paqe dhe anëtarësim në NATO. Prandaj kam besim të plotë se Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe të gjitha institucionet do ta kryejnë me kohë, jo në rrugë triumfaliste, por të drejtë kushtetuese dhe ligjore", është shprehur ai. Thaçi ka theksuar edhe nevojën për t'i përkrahur shqiptarët e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës në kërkesën e tyre për bashkëngjitjen e kësaj

hapësire shqiptare me Republikën e Kosovës. Duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, presidenti Thaçi ka ndarë edhe Medaljen Jubilarë Presidenciale të 10 -vjetorit të Pavarësisë, pas vdekjes, për prindërit e dy heronjve, Avdyll Krasniqin dhe Muhamet Lladrovcin.

## Veseli: Fehmi dhe Xhevë Lladrovci janë krenaria jonë kombëtare

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se sot e përgjithmonë në sheshin e Drenasit do të qëndrojnë shtatoret e dy figurave emblematike të luftës çlirimtare, Fehmiut dhe Xhevës. Ai ka theksuar se Fehmi dhe Xhevë Lladrovci nuk patën fatin t'i kenë fëmijët e tyre, por me sakrificën e tyre ata lanë një trashëgimtar të paçmueshëm: lirinë e Kosovës. "Vitet po kalojnë, gjeneratat vijnë njëra pas tjetrës, ne bashkëluftëtarët e tyre po plakemi, por veç një gjë nuk ndryshon kurrë: nderimi dhe respekti për heronjtë tanë. Ata janë gjithmonë me ne. Në mendjet dhe zemrat tona. Në identitetin e shtetit tonë të pavarur dhe sovran. Ata janë krenaria jonë kombëtare", ka deklaruar Veseli.

## Haradinaj: Në Drenasin e lirë u kthyen në shtatore heronjtë Fehmi dhe Xhevë Lladrovci

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se shqiptarët janë popull që e kanë përvojën më të gjatë në rrugën për liri. "Traditën për ta kultivuar lirinë, vlerat e lirisë dhe mundësinë, e kemi për të parën herë në Kosovë", ka deklaruar ai. Haradinaj ka theksuar se në Drenasin e lirë janë kthyer në përjetësi në shtatore heronjtë e kombit tonë, luftëtarët e shquar, njerëzit që e kanë gëzuar respektin e çdo bashkëluftëtarit dhe qytetari në ato kohë të vështira. "Kushdo që ka pasur nderin t'i njohë



sado shkurt, e di se kush ishin Fehmi dhe Xhevë Lladrovci. Përvurimi me respekt para kësaj veprë kaq të mirë dhe të qëlluar të kultivimit të vlerave të lirisë dhe përjetësisimit në shtatore të heronjve tanë", është shprehur kryeministri Haradinaj.

## Lladrovci: Rruga e Fehes dhe e Xhevës deri në këtë shesh zgjati 20 vjet

Ndërsa kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, njëherësh vëllai i dëshmorit Fehmi Lladrovci, ka thënë se rruga që Fehmiu dhe Xhevë Lladrovci të vinin deri në sheshin kryesor të kësaj komune ishte e gjatë. "Rruga e Fehes dhe e Xhevës deri në këtë shesh zgjati 20 vjet. Ishin vite të gjata dhe plot mall. Nga sot ata janë pjesë edhe e jetës sonë këtu në shesh, ashtu siç ishin dhe janë pjesë e idealeve tona për lirinë. Sot me

nderim të thellë përkujtojmë edhe heroinën nga Bistrica e Shalës, Fatime Hetemi, si dhe studentin nga Prishtina, Shefqet Zeka", ka thënë Lladrovci, duke shtuar se me vendosjen e këtyre shtatoreve është realizuar një punë e madhe.

## Jashari: Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, shembulli më i mirë si duhet fituar liria

Të pranishmit me një fjalë rasti i ka përhëndetur edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari. Ai ka thënë se kjo është ditë madhështore për kombin tonë meqë pas 20 vjetësh Fehmi dhe Xhevë Lladrovci u kthyen në bronz në zemrën e Drenasit dhe të Kosovës. Jashari ka thënë se Fehmi dhe Xhevë Lladrovci janë shembulli më i mirë se si duhet të fitohet liria dhe mbrojtur kombi.

## Meta: Ta çojmë përpara amanetin e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci

Ndërsa presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, e ka vlerësuar lart veprën e heronjve Fehmi dhe Xhevë Lladrovci. Ai ka thënë se shqiptarët e kanë për obligim ta çojnë përpara amanetin e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci. "Vlera e këtyre dy monumenteve madhështore që vendosen sot këtu nuk është vetëm nderim për veprën e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, por në mënyrë të veçantë që secili që kalon para këtyre monumenteve jo vetëm të përkulet me nderim, mirëpo ta çojë amanetin e tyre përpara", ka thënë Meta.

## Ahmeti: Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, figura të mëdha kombëtare

Edhe kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se Fehmi dhe Xhevë Lladrovci janë figura të mëdha kombëtare. Ai ka theksuar se këta dy heronj e pajisen me armë Drenicën dhe Kosovën. "Duart e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci pajisen me armë njësitet këtu në Drenicë dhe gjithandë Kosovës", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se Fehmi dhe Xhevë Lladrovci nuk kanë lënë pasardhës por, sipas tij, pasardhësit e tyre ishin të gjithë fëmijët e Kosovës.

## Imeri: Dëshmorët kishin një qëllim, bashkimin e shqiptarëve

Ndërsa përfaqësuesi i Luginës së Preshevës, Shkuri Imeri, ka thënë se Xhevë dhe Fehmi Lladrovci kanë dhënë jetën për lirinë e shtetit të Kosovës. Sipas tij, të gjithë dëshmorët kanë pasur për qëllim bashkimin e shqiptarëve, ashtu siç Zoti e ka falur Shqipërinë. "Në këtë drejtim Lugina e Preshevës pret mbështetjen e institucioneve të Kosovës", ka theksuar ai.



# Kosova dhe Japonia thellojnë bashkëpunimin ekonomik

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Ushtruesja e detyrës e ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, ka nënshkruar një marrëveshje me Agjencinë Japoneze të Turizmit për lehtësimin e zhvillimit ekonomik dhe për rritjen e potencialit të turizmit në të dy vendet. Krasniqi ka thënë se Republika e Kosovës është e përkushtuar t'i zgjerojë raportet me partnerët strategjikë siç është Japonia, prandaj edhe është iniciuar dhe finalizuar nënshkrimi i marrëveshjes me Agjencinë Japoneze e Turizmit. "Kjo marrëveshje do të ketë ndikim pozitiv për shtetin e Kosovës, njëkohësisht do të hapë mundësi të reja për të dyja vendet, sidomos në fushën e turizmit. Po kjo marrëveshje është një përvojë e re për Republikën e Kosovës sepse do të ketë shkëmbime të materialeve të

ndryshme dhe përvojave në turizëm dhe do ta lehtësojë komunikimin në mes të dyja vendeve", ka theksuar Krasniqi. Po ashtu, Republika e Kosovës është duke u prezantuar në Panairin e Turizmit në Japoni nga Agjencia për Promovimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, (KIESA) në kuadër të MTI-së, panair ky që synon ta promovojë turizmin e Kosovës dhe potencialin që e ofron Kosova. Në këtë panair po marrin pjesë dy kompani të Kosovës që janë përzgjedhur nga KIESA. Ushtruesja e detyrës e ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, ka theksuar se panairi është mundësi e mirë për t'iu treguar investitorëve japonezë për mundësitë që ofron Kosova në fushën e turizmit dhe investimeve. "Jemi të interesuar ta thellojmë bashkëpunimin ekonomik. Po ashtu, jemi të interesuar të kemi rritje të turistëve nga Japonia në Kosovë", ka thënë Krasniqi.



## Rritet mundësia e kreditimit për bizneset në Kosovë



PRISHTINË, 20 SHTATOR (ER) - Shoqata e Bankave të Kosovës ka njoftuar se bankat e Kosovës kanë rritur kreditimin për biznese këtë vit duke arritur në një rritje prej 11.3 përqindësh që është rritja më e madhe në tre vjetët e fundit. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka thënë se kjo rritje paraqet edhe rritje të qasjes në financa për bizneset, duke mbështetur kështu zgjerimin e bizneseve dhe rritjen e punësimit në Kosovë nga sektori real. Ai ka

treguar për punën e rëndësishme që janë duke bërë institucionet financiare, përkatësisht bankat e Kosovës, për ta financuar zhvillimin ekonomik të vendit i cili është ngushtë i ndërlidhur me perspektivën e Kosovës dhe zhvillimin e mëtutjeshëm social dhe ekonomik. Balija ka potencuar rëndësinë e zgjidhjes së çështjes së titujve pronësorë për t'u mundësuar ekonomive familjare në Kosovë që ta financojnë më lehtë dhe më lirë pronën e tyre të banimit, pasi ky është një parakusht i

rëndësishëm i mirëqenies socio-ekonomike të secilës familje. "Në këtë drejtim kërkohet që secili pushtet komunal të ketë një plan strategjik për t'i pajisur me tituj pronësorë të gjithë ata që janë të interesuar të blejnë pronë banesore si dhe atyre që tanimë veçse janë pronarë me kontratë të shitblerjes por që u mungon titulli pronësor", ka thënë Balija. Sipas tij, zgjidhja e kësaj çështje do të ndikonte në shumë hallka të ekonomisë së vendit të cilat janë të ndërlidhura me pronën.

## 65 për qind e bizneseve të kënaqura me mjedisin fiskal në Kosovë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Oda Amerikane në Kosovë ka realizuar një anketë të titulluar "Pulsi në sektorin privat mbi Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit" me mbi 500 biznese të Kosovës për të parë se si e vlerësojnë mjedisin fiskal në Kosovë. Rreth 65 për qind e tyre u shprehën të kënaqur me mjedisin fiskal dhe, sipas Odës Amerikane, kjo do ta jepte përgjigjen e kamotshme të bizneseve për heqjen e kësaj ngarkese tatimore. "Vlerësimi pozitiv i sistemit fiskal në vitin 2018 përbën një të arritur të rëndësishme duke pasur

parasysh se vetëm katër vjet më parë, rreth 60 % e bizneseve janë shprehur të pakënaqura me mjedisin fiskal, në një hulumtim të ngjashëm të kryer me ndërmarrjet që operojnë në Kosovë në kuadër të studimit "Gjendja e biznesit në Kosovë", është bërë me dije në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane. Ndërkaq Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë përsërit edhe kërkesën e saj të mëherëshme për riaktivizimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime të Ankesave të bizneseve karshi Administratës Tatimore dhe

Doganës ose gjetjen e një mundësie tjetër për ofrimin e një mekanizmi i cili do ta mundësonte trajtimin e kontesteve në shkallë të dytë. "Dyshkallshmëria në procedurë administrative, përpos që është e drejtë ligjore, do të ndikonte edhe në përmirësimin e mjedisit fiskal dhe, rrjedhimisht, mjedisit të përgjithshëm të të bërit biznes në vend", thuhet në komunikatë. Po ashtu, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë inkurajon Ministrinë e Financave dhe Qeverinë e Kosovës të vazhdojnë me masa të reja, përfshirë edhe zhven-



dosjen e mbledhjes së brendshme të tatimit mbi vlerën e shtuar të paralajmëruar të filluar nga 1 janari 2019.



Mbahet konferenca "Drejt një klime miqësore të biznesit dhe investimeve në Kosovë"

# Ministri Lluka: Ligji për Investimet Strategjike garanton investimet e huaja



Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë të enjten se Kosova e ka Ligjin për Investime Strategjike që i mbron investitorët potencialë dhe u jep garanci investitorëve të ndihen rehat. Ndërkaq shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova, ka vlerësuar se investimet janë me rëndësi kyçe për vendet e reja të punës

ndihen mirë kur vijnë të investojnë në Kosovë. Sipas tij, Ligji për Investime Strategjike u mundëson investitorëve të bashkëpunojnë me Qeverinë, të sjellin investitorë të tjerë dhe atyre që veç operojnë në Kosovë u mundëson siguri në investimet e tyre. "Këtu përfshihen edhe fushat të cilat i mbulon MZhe-ja si, p. sh., sektori i energjisë, TIK-u, posaçërisht sektori i minierave ku përmes Ligjit për Investime Strategjike mund të negociojnë me Qeverinë. Pra, ky ligj ua ka hapur derën investitorëve të negociojnë me Qeverinë dhe përmes këtij bashkëpunimi të kuptojnë se kush janë investitorët seriozë që duan të investojnë në sektorët kyç", ka thënë ai. Sa i përket sektorit të energjisë, Lluka ka theksuar se ai përballet me disa probleme, mirëpo në dhjetor të vitit të kaluar është nënshkruar marrëveshja me kompaninë amerikane "Contour Global" për ndërtimin e TC "Kosova e Re", që i hap rrugë ndërtimit të kapaciteteve

të reja gjeneruese, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve të bizneseve ekzistuese dhe atyre që janë të interesuara të investojnë në Kosovë.

I pari i MZhe-së ka folur edhe për mundësitë për investime që ofrojnë sektorët strategjikë si minierat dhe teknologjia e informacionit, për të cilat ka interesim për investime të huaja që do të ndikonte që Kosova të ketë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Për rolin e klimës së investimeve në rritjen ekonomike, në hyrje të konferencës folën edhe ministri i Financave, Bedri Hamza dhe shefja e Zyrës së BE-së, Nataliya Apostolova. Hamza ka thënë se kohët e fundit rritja ekonomike në Kosovë ka arritur deri në 4 për qind, që është rritja më e lartë në rajon, por nuk është e mjaftueshme. "Kemi nevojë të kalojmë në nivel tjetër të rritjes ekonomike, e kjo mund të arrihet vetëm duke qenë bartës sektori privat", ka thënë ministri Hamza.

Ndërsa Apostolova ka vlerësuar se investimet janë me rëndësi kyçe për vendet e reja të punës. "Takimi i sotëm synon që ta paraqesë botimin e parë të sfidave në mjedisin e biznesit në Kosovë, në Telekom, banka, sigurime, derivate, miniera dhe xehe, duke dhënë rekomandime konkrete për atë se si të përmirësohet mjedisi i biznesit në Kosovë. Dhe, ky duhet të shërbejë si instrument për Qeverinë se si të zhvillohet mjedisi i biznesit në Kosovë", ka thënë ajo.

"White Book" është një udhëzues gjithëpërfshirës i hartuar nga KEI për të dhënë propozime për përmirësimin e klimës së investimeve në Kosovë në mënyrë që ta nxisë zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është të kontribuojë në një dialog të strukturuar dhe të qëndrueshëm mes sektorit privat dhe Qeverisë së Kosovës.

"White Book" publikohet për herë të parë dhe parashikohet të publikohet çdo vit.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 SHTATOR - "Kosova e ka Ligjin për Investime Strategjike që i mbron investitorët potencialë dhe u jep garanci. Po ashtu, kemi nënshkruar memorandume me shumë shtete të BE-së dhe këto memorandume luajnë rol të rëndësishëm në fushën e investimeve të mundshme, të cilat u japin garanci investitorëve të ndihen rehat në Kosovë", ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka. Këto komente kreu i MZhe-së i ka bërë të enjten në konferencën "Drejt një klime miqësore të biz-

nesit dhe investimeve në Kosovë", ku morën pjesë edhe ministri i Financave, Bedri Hamza, shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova, përfaqësues të Bankës Botërore, të BERZh-it, FMN-së dhe Këshillit Evropian për Investime (KEI), me ç'rast u publikua edhe dokumenti "White Book 2018".

Duke folur në panelin "Klima e investimeve në Kosovë - mundësitë dhe sfidat", ministri Lluka ka pohuar se në takimet e shumta me investitorë, të interesuar të investojnë në Kosovë, është fokusuar se si mund të përmirësohet klima e investimeve që investitorët të



## Gjilani shënon 'Ditën pa makina'

**GJILAN, 20 SHTATOR (ER)** - Komuna e Gjilanit ka organizuar të enjten aktivitetin "Dita pa makina" në kuadër të aktivitetit "Ta pastrojmë Kosovën" për t'i përdorur më tepër biçikletat, sepse shëndeti është më i mirë për njeriun, shërbimet janë më të shpejta dhe ambienti është më i patër.

Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, i cili së bashku me komandantin e policisë dhe me zyrtarë komunalë e qytetarë kanë marshuar nëpër qytet me biçikleta, u ka bërë thirrje qytetarëve të ecin më tepër këmbë dhe me biçikleta për ta shmangur ndotjen e ambientit që shkaktojnë veturat.



## Në Mitrovicë gjashtë familje do të bëhen me shtëpi të reja

**MITROVICË, 20 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, është takuar të enjten me banorët e fshatit Kçiq i Vogël të cilët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre lidhur me projektin e komunës për ndërtimin e disa shtëpive në afërsi të fshatit të lartpërmendur për familjet me gjendje të rëndë ekonomike-sociale të cilat nuk e kanë të siguruar stre-

himin. Bahtiri i ka njoftuar banorët e fshatit Kçiq se Komuna e Mitrovicës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë "Buçaj" për ndërtimin e disa shtëpive për familjet që nuk e kanë të rregulluar çështjen e strehimit, me ç'rast komuna ka marrë përsipër sigurimin e tokës për ndërtimin e shtëpive, vendim ky i cili është aprovuar edhe

në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, pasi hapësira e siguruar është pronë komunale. "Ky projekt patjetër do të realizohet sepse është i rëndësishëm për familjet në nevojë, për të cilat komuna ka obligim të përkujdeset, andaj edhe e ka identifikuar hapësirën e saj afër fshatit Kçiq i Vogël si më të përshtatshme për realizimin e projektit", ka thënë Bahtiri.



## Haskuka: Prizreni është me fat që ka shkollën 'Loyola'

**PRIZREN, 20 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka vizituar shkollën 'Loyola' në këtë qytet. Ai ka thënë se Prizreni është qytet me fat që ka një shkollë me standarde të larta. "Këtë vit kjo shkollë ka filluar të funksionojë edhe me qendrën e

saj të re edukative 'Loyola tranzit'. Kjo qendër është një storie e suksesit në vete falë vullnetit të madh të atyre që u angazhuan për realizimin e këtij projekti është krijuar një mundësi e re për nxënësit, sidomos të atyre nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian që

jetojnë në afërsi të kësaj lagjeje për t'i zhvilluar aktivitetet e tyre shkollore dhe edukative. I përgëzoj të gjithë ata që janë angazhuar për realizimin e këtij projekti, ndërsa nxënësve të kësaj shkolle u uroj një vit të mbarë shkollor", ka deklaruar Haskuka.

## Latifi viziton Qendrat e Mjekësisë Familjare në Krushë të Madhe dhe Ratkoc

**RAHOVEC, 20 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka vizituar Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në fshatin Krushë të Madhe dhe atë në Ratkoc. Latifi gjatë kësaj vizite ka vlerësuar zgjatjen e orarit të

punës në ndërrimin e dytë deri në orën 21:00. Ai ka thënë se ia ka vlejtur të zgjatet orari i punës (ndërrimi i dytë) deri në orën 21:00. "Ne do të vazhdojmë t'u rrimë përballë zotimeve tona publike", ka thënë kryetari Latifi.



## Sanohen gropat në 'Kodrën e Trimave'

**PRISHTINË, 20 SHTATOR (ER)** - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se të enjten ka përfunduar sanimi i gropave në rrugën "27 Nëntori" në lagjen "Kodra e Trimave" në kryeqytet. Kjo komunë ka theksuar se rregullimi i kësaj rruge ka ndodhur pas kërkesave të banorëve të kësaj lagjeje. "Sot përfundon sanimi i gropave edhe në rrugën '27 Nëntori' në 'Kodrën e Trimave'. Zbatimi i kontratës kornizë për inter-



venime të tilla po bëhet duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve në faqen 'Prishtina pa gropa', ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



# Veteranët mashtrues, veteranët e vërtetë dhe hienat kundër luftës çlirimtare!



**Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA dhe shokët e  
Fehmi dhe Xhevë  
LLADROVCIT**

Kush ha molla dhe kujt i mpihen dhëmbët: Pas bërjes publike të listave të ish- veteranëve të UÇK-së, e që dyshohen të jenë mashtrues, duke përfutur pamoralshëm dhe kundërligjshëm nga djersa dhe gjaku i veteranëve të vërtetë, për vite të tëra u shkaktua një rrëmujë e vërtetë kur doli se në ato lista ka ushtarë të devotshëm, sakrificues, por edhe dëshmorë të UÇK-së. Dikush, mbase, me të drejtë thotë se ky diversion në formë të mishmashit (veteranë të dyshuar si mashtrues dhe veteranë të vërtetë në të njëjtën listë) është bërë me qëllim që të mos sillen para përgjegjesisë penale ata që kontribuuan në fryrje të listave sikur edhe me qëllim të zhvendoset vëmendja kah zhvillimet aktuale që po e dëmtojnë vendin duke vënë në pyetje sakrificën dhe qëllimet për çka është bërë lufta dhe duke i rikthyer fuqishëm në lojë ata që e penguan luftën dhe që ishin në krahun jugosllav, serb dhe kundërshqiptar.

Komisioni qeveritar për verifikimin dhe njohjen e statusit të veteranit të luftës së UÇK-së, përveçse edhe zyrtarisht është akuzuar për shpërdorim të detyrës zyrtare, në të njëjtën kohë i është nënshtruar edhe një linçimi publik sikur të ishte i vetmi mekanizëm që bart përgjegjësi për sajimin e listave të veteranëve të dyshuar të jenë mashtrues. Realisht, përgjegjësia kryesore për fryrje të listave të veteranëve bie mbi komandantët e zonave operative, komandantë të brigadave dhe të nivelit më të ulët të komandimit e që kanë dërguar lista me emra të veteranëve, qofshin ata të vërtetë apo edhe mashtrues, tash në fazën e dyshimit. Në të njëjtën kohë, po ky kuadër komandues, nga niveli më i lartë deri tek ai më i ulët, ka përgjegjësi dhe detyrim, moral dhe njerëzor, që t'i mbrojnë veteranët e vërtetë e që po përballen, pa të drejtë me një baltosje publike, si ata ashtu

edhe familjet e tyre. Nuk mbahet mend që pas përfundimit të ndonjë lufte, ata që e bënë luftën t'i nënshtrohen një sulmi aq të paskrupullt dhe aq të ulët sa i nënshtrohen ish-ushtarët e së lavdishmes UÇK, shumica e të cilëve janë raste sociale dhe ky sulm u bëhet pikërisht nga ata që e penguan dhe sabotuan luftën dhe të cilët edhe vetë, pameritueshëm janë në listat e veteranëve, jo atyre që janë mashtrues, por të atyre të vërtetë. Nuk ka vend dhe shtet ku janë përndjekur më shumë luftëtarët që luftuan për liri se në Kosovë, si nga "drejtësia" ndërkombëtare, ajo e Serbisë, sikur edhe nga mbetjet e saj në Kosovë. Nëse dikush e ka merituar t'i ngrihet aktakuzë për një fryrje enorme të ish-veteranëve të UÇK-së atëherë, përveç kuadrit komandues të të gjitha niveleve, në radhë të parë do të duhej t'i nënshtroheshin përgjegjesisë penale një pjesë e "elitës" politike të Kosovës që në mënyrën më të poshtë ka flirtuar me ata që e kanë sabotuar luftën duke i bërë, brenda natës veteranë të UÇK-së dhe, për turp, edhe heronj të kombit. Këta horra jo që nuk e shkrepen asnjë plumb në luftë, por mriзонin në Shqipëri me një uniformë të sajuar dhe bënëin modeling nëpër hotele dhe improvizonin "stërvitje" ushtarake. Deri dhe ishin në radhët e Serbisë, kurse brenda nate u bënë më patriotë se Hasan Prishtina. U bënë veteranë ata që humbën jetën aksidentalisht me makinë apo që u helmuan me ujë të kontaminuar të një pusi. Lufta e fundit në Kosovë ishte imponim, po do të duhej të ishte detyrim për të gjithë sepse liria është e pandashme, ishte shprehje dhe ndërgjegje çlirimtare, ishte etje dhe uri për liri, ishte kusht për mbijetesë dhe histori e shkruar me djersë dhe gjak, ishte përpjekje që përmes së tashmes, ta ndërtojme të ardhmen për fëmijët tanë, për pasardhësit tanë dhe për jetësimin e idealeve të atyre që sakrificuan çdo gjë që e patën që nga Hasan Prishtina, Azem Bejta dhe Shotë Galica, Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica, Gjon Serreçi dhe Marie Shllaku, Imer Berisha dhe Fazli Grajçevci, Shaban Shala dhe Xheladin Rekalio, Tahir dhe Nebih Meha, Abedin Rexha dhe Bekim Berisha, Bedri Shala dhe Agim Ramadani, Sali Çekaj dhe Remzi Ademaj, Shkelzen Haradinaj dhe Hakif Zejnullahu, Luan Haradinaj dhe Zahir

Pajaziti, Fadi Vata dhe Edmond Hoxha, Ilaz Kodra dhe Fatime Hetemi dhe deri tek ushtarët e përjetshëm dhe të pavdekshëm të dy gjeneralëve të shqiptarisë, atij politik, Baca Adem Demaçi dhe atij ushtarak, komandantit legjendar Adem Jashari, përjetësia kombëtare, historike dhe heroike, Xhevë dhe Fehmi Lladrovci, me ushtarët e tjerë të lirisë si Rexhep Mala, Afrim Zhitia, vëllezërit Fazliu dhe heronjtë e tjerë që e flajuan jetën edhe të horrave që sot me aq zell, vullnet dhe sadizëm e sulmojnë UÇK-në dhe veteranët e vërtetë të saj. Mos të harroj këtu pa i përmendur edhe heronjtë më të rinj të Kosovës e që janë Hashim Thaçi dhe Behgjet Pacolli. Po mos t'i përmendja, historia kurrë nuk do të më falte. Lavdia, nderimi dhe përjetësia u takon atyre që luftuan dhe u sakrificuan për kombin dhe atdheun, kurse përbuzja dhe turpi atyre që e përbuzin luftën dhe sakrificën. Sa për Rugovën dhe një pjesë të LDK-së, kurrë nuk do të kishte luftë çlirimtare në Kosovë, as liri për Kosovën. Ata e shtrinë qafën dhe nuk kishin kurriz të qëndresës as gatishmëri edhe për sakrificën më të vogël. Sikur as majat dhe tatat e këtyre, që në emër të vlerave demokratike dhe lirisë së shprehjes nuk kanë lënë gjë pa bërë dhe nuk kanë lënë kujt pa iu nënshtruar apo pa iu lëshuar brekët. Lufta ishte e lavdishme, e paimagjinueshme, e papërsëritshme dhe përtej çdo imagjinatë kundërshtuese ndaj Jugosllavisë dhe Serbisë. Duhet të bëhet një prerje e kohës se çka u bë gjatë luftës dhe çka u bë pas luftës! Tash këta që e penguan luftën dhe nuk kanë lënë kujt pa iu shërbyer dhe pa iu nënshtruar duke punuar kundër interesave të popullit që, për fat të keq, e flisnin gjuhën e tyre, por mendjen dhe shpirtin e kishin kundër kësaj gjuhe! Lufta nuk mund të përvetësohet dhe duhet të jesh i çmendur e të bësh përpjekje qoftë edhe alkimike që m... ta shndërrosh në barot. Për luftën dhe sakrificën që e kanë bërë, lavdi deri në qiell! Për disa veprime që i kanë bërë pas përfundimit të luftës, u shkoftë turpi deri në qiell! Përjetësimi i dy kolosëve kombëtarë në Drenas: Sot në Drenas u përurua lapidari i dy kolosëve të kombit që me jetën dhe sakrificën e tyre e vulosën përjetësisht historinë e popullit shqiptar dhe luftën për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar, të Xhevë

Krasniqi-Lladrovci dhe Fehmi Lladrovci. Si të padenjë që jemi për respektimin e vlerave kombëtare jemi vonuar shumë për ngritjen e kësaj përmendoreje të kujtimit për dy heronj që me aq lehtësi e sakrificuan jetën, në shërbim të atdheut dhe kombit. Në një mënyrë a tjetër në këtë ceremoni inauguruese ishin shqiptarët nga të gjitha trojet shqiptare e që nënkupton se u bë një bashkim kombëtar. Kur është fjala te bashkimi kombëtar çasti më i mirë ishte zbulimi i lapidarit që, për çudi, nuk u bë nga politikanët tanë legjendarë, por nga fëmijët e atyre që e dhanë jetën e tyre për t'u bërë këta politikanë të tillë siç ndihen, politikanë legjendarë! Kjo më bëri përshtypje të jashtëzakonshme, ndërsa ishte shumë pozitiv "demilitarizimi" apo çarmatosja e heronjve nga armatimi i rëndë sikur janë lapidarët e tjerë nga koha e socializmit realist. Xheva dhe Fehmiu janë monumentale jo për shkak të madhësisë së lapidarit, por për shkak të sakrificës dhe veprave që lanë pas. Feha pak më përngjante në Fidel Kastron dhe Çe Gevarën në ditët e mira të tyre, por edhe ashtu dukej madhështor. E ndieja për detyrim të jem aty për shkak të sakrificës së tyre dhe kohës së përbashkët të kaluar në llogoret e ish-Jugosllavisë. Ishim aty bashkë, Nuhi Llapqini, Dul Taraku, Tahir Zhidovi, Idrizi, Bejta, Binaku dhe shokë të tjerë, por se ishin larg politikanëve legjendarë që ishin kurdisur në rreshtat e parë bashkë, nacionalistë, lpkistë dhe komunistë të Titos. Më habiti fakti se nuk u gjet një karrige për Binak Dinajn, shok dhe bashkëluftëtar i Fehmiut dhe Xhevës, dhe i cili e la dorën në betejën e Loxhës, kur dezertorët e kolonelit ia mbathën për Shqipëri pasi e siguruan korridorin e lirë për tërheqje, duke e lënë Ramushin me afërsisht 30 ushtarë e që disa prej tyre, prokurori Blakaj i ka futur në listën e hetimeve si veteranë mashtrues. Pas përrurimit të lapidarit, si e do rendi dhe zakoni në skenë dolën politikanët tanë legjendarë që i lexonin fjalimet kryesisht të shkruar nga të tjerët. Ana tjetër e medaljes heroike të Behgjet Pacollit, Shkëlqesia Hashim, e bëri një pelegrinazh parapolitik duke i bashkuar të gjitha trojet shqiptare. Fiksion i është bërë Lugina e Preshevës sikur që Lugina e Silikonit ishte fikSION i Bill Gejtsit. Derisa nga Bill Gejtsi përfitoi e tërë bota, nga Hashimi mund të përfitojë Behgjeti dhe hajdutët dhe

llaskuçët rreth Hashimit. Kurse këta të Luginës së Preshevës e që moti janë bashkuar me Kosovën sepse jetojnë dhe punojnë në Kosovë që nga përfundimi i luftës e disa edhe më herët do të fitojnë të trashët e surrzles e që unë e përktej në të trashët e Hashimit. Do të binden këta sikur edhe ne, besoj shumë shpejt. Të gjithë folën fjalë të zgjedhura për Xhevë dhe Fehmi Lladrovcin, por më shumë folën për veten e tyre se si janë të nderuar dhe privilegjuar që e kanë njohur, bashkëpunuar dhe disa, besa edhe paskan luftuar me Xhevë dhe Fehmi Lladrovcin. Nuk ka shumë kohë që kaloi në përjetësi komandanti politik i Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Baca Adem Demaçi. Të gjithë që i kanë njohur Fehën dhe Xhevën dhe ata që kanë qenë një minutë të vetme me ta e dinë se Fehmiu dhe Xheva kanë qenë në gjendje që në çdo kohë të shkrihen për bacën Adem dhe se vetëm atë e kanë pranuar si autoritet politik sikur që komandantin legjendar Adem Jasharin e kanë pranuar si autoritet ushtarak. Askush në fjalimet e shkruara nga të tjerët nuk e zunë në gojë emrin e Bacës Adem, sigurisht nga turpi dhe brejtja e ndërgjegjes për atë që e kanë bërë dhe disa prej tyre po e bëjnë edhe sot duke shkëlur mbi gjakun e dëshmorëve në përgjithësi kurse, në rastin konkret, mbi gjakun dhe sakrificën e Xhevë Krasniqi-Lladrovci dhe Fehmi Lladrovci. Është kohë e shkurtër për ta harruar një bjeshkë njerëzore, kombëtare, morale dhe politike siç është Baca Adem Demaçi. Ata që e kanë ndjenjen e paturpit nuk e bëjnë këtë me qëllim dhe nëse gabojnë, e përmirësojnë gabimin, kurse injorantët dhe të mjerët, me rroba Prada, syze Guçi, puro Davidoff, brekë Luj Viton e që nuk u kanë mbetur koç... as për brekushe Made in China, me sadizëm e bëjnë këtë apo siç thotë Niçe, ta mbyesë Zotin e të bëhem vetë Zoti! Në këtë manifestim me interes kombëtar duket se mungoi opozita, e sidomos "krahu i luftës" në krye me komandant Dullën. Edhe heronjtë i kemi ndarë, vetëm hajnia dhe e keqja po na bashkon. Lavdi heronjve të vërtetë të kombit shqiptar, Xhevë dhe Fehmi Lladrovci dhe kujtim i përjetshëm për mësuesin e tyre politik, të Madhin Bacë Adem Demaçi, si dhe komandantin ushtarak, komandantin legjendar Adem Jashari.



## Sulm me armë në ShBA, 3 viktima e disa të plagosur

WASHINGTON, 20 SHTATOR - Tri viktima dhe disa të plagosur është bilanci i një sulmi me armë të ndodhur të enjten në Maryland të Amerikës. Policia raporton se ngjarja e rëndë ka

ndodhur në një qendër ku shpërndahen dhe përpunohen artikuj farmaceutikë, në Maryland të Amerikës. Në ambientin e sulmit punonjë rreth 1000 punonjës. Ende

është herët për të thënë nëse është një sulm terrorist, ndërkohë që edhe autori nuk është identifikuar. Policia kërkon që qytetarit të rrinë brenda në shtëpi pasi autori

është ende i lirë. Në vendin e ngjarjes ka shkuar dhe FBI-ja por ende nuk është e qartë se çfarë po ndodh. Situata është vlerësuar si tepër e rëndë.



# Nëse lë Turqinë në dorë të Ruisisë e Iranit, Perëndimi mund ta paguajë shtrenjtë

Ambicjet e Turqisë për t'u bashkuar me BE-në duhen rigjallëruar në mënyrë urgjente, që të vazhdojnë të nxiten reforma liberale. Përndryshe, Perëndimi do të paguante një çmim të madh për humbjen e një vendi të tillë si aleat

WASHINGTON, 20 SHTATOR - Marrëdhëniet midis dy vendeve arritën në pikën më të ulët kur presidenti amerikan dyfishoi tarifën për çelikut dhe aluminit, si përgjigje ndaj refuzimit të Turqisë për të liruar Endrju Brunsonin, një prift amerikan që mbahet në arrest shtëpie në Turqi, me akuzë për terrorizëm.

Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, deri tani i ka rezistuar presionit për të marrë masa monetare dhe fiskale, por ka zgjedhur të sulmojë ShBA-në dhe tregjet financiare.

Ai po sugjeron se ka nisur një komplot botëror për t'i shkatërruar arrijet politike dhe ekonomike të Turqisë.

Popullariteti i tij në Turqi ka qenë në rritje deri tani, pasi u ka mëshuar ndjenjave anti-amerikane (dhe prirjes për të besuar teoritë e komplotit) të cilat janë shumë të përhapura mes popullit turk.

Përgjigja kokëfortë e Erdoganit ndaj krizës ekonomike të Turqisë


ngjan me metodat populiste të presidentit venezuelas, Nikolas Maduro, dhe janë shumë larg qëndrimit miqësor ndaj tregjeve që ka mbajtur presidenti argjentinas, Mauricio Makri.

Ndryshe nga Argjentina, Turqia nuk duket e gatshme t'i drejtohet FMN-së për të shpëtuar krizën financiare, dhe as duket se ka nevojë t'i përmirësojë marrëdhëniet me Uashingtonin.

Presidenti Turk duket se ka vendosur t'i shtojë përpjekjet për të sfiduar Amerikën dhe tregjet financiare botërore, të dy kundërshtarë aspak të lehtë.

Gjasat janë që Turqia t'i humbë betejat kundër Nju Jorkut, Londrës, Singaporit e bastioneve të tjera financiare, nëse nuk deklaron armëpushim. Rënia e fuqisë së lirës turke do të përkthehet në një shkatërrim ekonomik e financiar në Turqi.

Teksa ky proces të jetë në zhvillim e sipër, Erdogan mund të humbasë mbështetje popullore, edhe atë të mbështetësve më të



përkushtuar ideologjikë, gjë që do të linte pas vetëm paqëndrueshmëri politike.

Pasojat do të krijonin probleme të gjata e të ndërlikuara, të cilat mund të çojnë te kërkesat për ndërhyrjen e ushtrisë në politikë, si dhe të prodhonin probleme të mëtejshme, edhe jashtë kufijve të Turqisë.

Turqia, nga ana tjetër, mund të arrijë në pikën që të mos e ketë më ShBA-në si një partner të qëndrueshëm e strategjik.

Kujtudo që do t'i binte radha ta drejtonte vendin, një Turqi e plagosur do ta kthente qendrën e

rëndesës larg Perëndimit dhe më afër Ruisisë, Iranit dhe Euroazisë.

Turqia nuk do të ishte më në linjë me qëllimet e ShBA-së dhe BE-së në Lindjen e Mesme. Si rrjedhojë, do t'i duhej të krijonte një politikë mbrojtjeje dhe sigurie më të pavarur.

Në rrethana ekstreme, Turqia do të mendonte edhe largimin nga NATO-ja dhe mbylljen e marrëveshjes së doganave me BE-në. Asnjë skenar nuk duhet nënvlerësuar, nëse ndodh më e keqja dhe trazirat politike dhe ekonomike sjellin shkatërrim në një vend më

rëndësi aq të madhe gjeopolitike

sa Turqia.

Meqë pasojat do të ishin shumë të rënda, është më se e logjikshme që Perëndimi të përgatisë një pako ambicioze për të lehtësuar impaktin e cunamit financiar, në mënyrë që Turqia të mos largohet nga standardet the institucionet perëndimore.

Ambicjet e Turqisë për t'u bashkuar me BE-në duhen rigjallëruar në mënyrë urgjente, që të vazhdojnë të nxiten reforma liberale. Përndryshe, Perëndimi do të paguante një çmim të madh për humbjen e një vendi të tillë si aleat.

## May shpalos prioritetet e Brexit-it para homologëve evropianë

SALCBURG, 20 SHTATOR - Kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May, kërkoj nga udhëheqësit e Bashkimit Evropian që të përqendrohen në arrijtjen e marrëveshjes për Brexit në dy muajt e ardhshëm, duke thënë se negociatat nuk do të zgjaten.

Brexit-i nënkupton procesin e daljes së Britanisë nga BE-ja, i cili duhet të përfundojë në mars të vitit të ardhshëm.

Ndër çështjet më të diskutueshme janë nivelet e integritimit të Britanisë me tregun e përbashkët të BE-së pas Brexit-it dhe natyra e kufirit midis Irlandës së Veriut - e cila është pjesë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës - anëtare të BE-së. Në një darkë pune në Salzburg, May u tha 27 homologëve evropianë se prioritet i saj janë mbajtja e lidhjeve ekonomike me BE-në dhe mbrojtja e



Irlandës Veriore brenda Britanisë.

Brukseli këmbëngul se Irlanda e Veriut duhet të mbetet në përputhje me rregullat e saj, nëse nuk mund të gjendet një zgjidhje tjetër për t'i parandaluar kontrollet fizike të kalimit të mallrave në dhe nga Republika Irlandeze.

May tha se Brexit-i është një sfidë e komplikuar, porse duhet të përfundojë në kohë.

## Moon: Kimi dëshiron një takim të dytë me presidentin Trump

SEUL, 20 SHTATOR - Presidenti i Koresë së Jugut Moon Jae-in bëri të ditur se udhëheqësi i Koresë së Veriut Kim Jong Un, dëshiron të mbajë një takim të dytë me presidentin amerikan Donald Trump, me qëllim shpejtimin e procesit të çarmatimit bërthamor të

gadishullit Korean.

Presidenti Moon i bëri komentet të enjten në Seul, pas kthimit të tij nga një vizitë treditore në Phenian. Vizita e Moon në Phenian kishte si qëllim tejkalimin e ngërçit në marrëdhëniet mes Koresë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara lidhur

me ritmin e Phenianit për të përbushur premtimin për t'i dhënë fund programeve të tij të raketave bërthamore e balistike. Në takimin e tyre në Singapor në muajin qershor udhëheqësi i Phenianit dhe presidenti Trump nënshkruan një marrëveshje të

paqartë mbi çarmatimin bërthamor.

Presidenti i Koresë së Jugut u tha gjithashtu gazetarëve se Kim Jong Un shpreson që Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo të vizitojë së shpejti Korenë e Veriut.





Shënim kulturor nga Hamburgu

# NË HAMBURG U MBAJT 'E DIELA POETIKE'

Javën që lamë pas në Hamburg është organizuar një takim kulturor, përgatitur dhe ideuar nga Sadbere Emshiu-Karimani, pedagoge në shkollën e Veddelit në Hamburg, njëherësh nëpunëse në Ministrinë e Arsimit të Hamburgut. Me këtë organizim ajo synon që takimet e tilla kulturore në të ardhmen të shpeshohen, së paku çdo tre muaj. Zonja Sadbere këtë herë, së bashku me Shoqatën e Grave

"Alb Universum" nga Berlioni, këtë takim e quajtnë "E diela poetike". Në këtë takim kishin ftuar poeten nga Tirana, zonjën Majlinda Zorba dhe poetin Arif Molliqi nga Kosova që jeton në Hamburg.

Në një ambient të ngrohtë, të përgatitur nga vëllezërit Ali dhe Ymërlë Gërdellaj, përveç krijuesve, morën pjesë edhe një numër i konsiderueshëm i dashamirëve të poezisë, disa



prej anëtarëve të Shoqatës "Alb Universum" nga Berlioni, studentë gjermanë dhe qytetarë të komunitetit turq që jetojnë në Hamburg. Ishte i pranishëm edhe kryetari i Shoqatës "Gjermano-Shqiptare" në Hamburg, Adreas Hemming, me bashkëpunëtorë.

Zonja Sadbere me nikoqirët kishin përgatitur edhe një koktej rasti për pjesëmarrësit me ushqime tradicionale dhe internacionale.

Në fillim fjalën e mori zonja Sadbere, e cila shpjegoi idenë dhe qëllimin e këtyre takimeve me lexime poetike. "Këtë herë kemi ftuar dy krijues, zonjën

Majlinda Zorba, me librin e saj të fundit 'Kalorësi i bardhë' dhe Arif Molliqin, me librin 'Si kripën të kam dashtë'. Këto takime dhe lexime poetike, me titull 'E diela poetike', mendojmë t'i çojmë edhe më tutje, që në të ardhmen të organizohen më shpesh, së paku çdo tre muaj. Për fillim kemi ftuar dy krijues të cilët nuk do t'i lexojnë poezitë e veta, por të njëri-tjetrit", tha zonja Sadbere, e cila fjalën ia dha poetes Majlinda.

Majlinda Zorba për lexim dhe recitim kishte zgjedhur disa poezi të Molliqit. Leximi dhe recitimi i poezive të zgjedhura nga libri "Si kripën të kam

dashtë" u pritën mirë dhe lanë mbresa tek të pranishmit, kurse gjermano-folësve ua përkthente zonja Sadbere.

Ndërkaq poezitë dhe një tregim të Majlindës i lexoi zotëri Molliqi.

Në të dielën poetike, përveç leximit të poezive që u bënë nga autorët, të pranishmit shkëmbyen mendime rreth poezive të lexuara dhe rreth përmbajtjeve të tyre. Pastaj autorët folën për jetën e tyre, për rrugën e gjatë dhe të vështirë deri te botimi i një libri çfarëdo qoftë ai. Në përfundim të takimit u tha se organizimet e tilla janë shumë të nevojshme për mërgatën tonë.

## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



**E jashtëzakonshme**

## Në Greqi krijohet një rrjetë merimange gjigante



Moti më i nxehtë ishte në Greqinë perëndimore dhe ka çuar në një spektakël thuajse të mbinatyrshëm, për krijimin e një rrjete merimange

300 metra e gjatë në Aitoliko. Një zonë e gjerë e gjelbër është mbuluar nga rrjeta e merimangës dhe ekspertët thonë se bëhet fjalë

për një fenomen sezonal, të shkaktuar nga merimanga 'Tetragnatha', që mund të ndërtojë fole të stërmëdha për çiftëzim.

**FOTO E DITES**




Fëmijët përdorin një gomë për të kaluar një rrugë të përmbytur në Filipine. /AFP/

**E rrallë**

## Arkeologët egjiptianë gjejnë sfinksin në tempullin Aswan

Arkeologët egjiptianë kanë zbuluar statujën e një sfinksi në qytetin jugor të Aswanit. Ministria e Antikiteteve ka njoftuar se statuja e bishës mitike me kokën e një njeriu dhe trupin e një luani u realizua me gurë ranorë dhe supozohet se daton në dinastinë Ptolemaike, e cila sundoi Egjiptin deri në pushtimin romak në



vitin 30 para Krishtit. Sfinksin përfaqësonte fuqinë mbretërore në Egjiptin faraonik, duke kombinuar fuqinë fizike të një luani me fuqinë tokësore të një mbreti.

**BARSOLETA E DITËS**



- Punëtori: Sa është roga?
- Fillimisht 300 euro, kurse më vonë bëhet 600 euro!
- Ani se vij më vonë, pra!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

### “HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation” 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

### “THE DARKEST MINDS”

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

### “THE PREDATOR” 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Jeni të etur për dije këto kohë dhe lexoni gjithçka që ju bie në dorë. Fëmijët janë shumë në humor në shoqërinë tuaj dhe sot do të kaloni kohë me ta.</p>	 <p><b>DEMI</b> Ndiheni shumë të kënaqur nga vetja sot sepse investimi i bërë në një fushë të caktuar ka dhënë rezultatet e veta.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Duhet të mësoni disa teknika relaksimi sot sepse dita do të jetë e ngarkuar me situata të ndezura dhe mjaft të tensionuara.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Nëse nuk afroheni me personat që keni pranë do të krijoni ngecje në një projekt të rëndësishëm tuajin.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot keni drojë të kërkoni ndihmë për një problem të lindur. Nëse e lini pas dore nuk do të mund ta shfrytëzoni kohën e humbur.</p>	 <p><b>IRGJËRESHA</b> Mos lejoni askënd t'ju thotë se kush është gjëja më e rëndësishme për ju. E dini mjaft mirë se cilat janë synimet tuaja.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sot mund t'i ndihmoni personat që kanë nevojë. Një nismë e juaja do të pasohet nga shumë gjëra të bukura në vazhdim.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Kolegët kanë organizuar një festë surprizë për ju dhe për gjithçka keni arritur bashkërisht. Do të emocionoheni, gjë që ju ndodh rrallë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Gjithçka që doni të bëni sot ka nga pas një ngërç të vogël që do t'ju marrë kohë dhe energji. Do të kërkoni më shumë vëmendje nga partneri.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Jeni në humor të mirë sot dhe prireni t'i bëni dhurata kujt do që takoni. Do të ketë mjaft batuta në grupin tuaj shoqëror për ju.</p>	 <p><b>UJORI</b> Jeni në udhëkryq dhe disi në panik për vendimet që do t'ju duhet të merrni. Kjo frikë e juaja do të reflektohet në çdo hap që do të bëni sot.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Ballafaqimi me persona të caktuar sot duhet të jetë sa më i qetë dhe pa asnjë emocion nga ana juaj. Do të kërkoni atë që doni.</p>



## Ish i dashuri nuk i ndahet asnjë sekondë Demi Lovatos



**K**ëngëtarja Demi Lovato ka nisur rehabilitimin për ta kaluar gjendjen e mbidozës që përjetoj para dy muajsh dhe një person nuk i është ndarë për asnjë çast. Burime të "TMZ"-së kanë konfirmuar se Wilmer Valderrama (ish i


dashuri) ka qenë pranë saj edhe kur u transferua nga një qendër rehabilitimi te një tjetër me programe të veçanta. Demi ka disa kohë që është zhvendosur në një qendër në Chicago dhe Wilmer ka shkuar në ditët e vizitave për ta takuar.

## Bella, Gigi e Kendall shkëlqejnë në sfilatën e Ferrettit



**A**jo mahnit të gjithë në sfilatën e Burberryt në Londër në fillim të javës. E Kendall Jenner nuk po tregon shenja se e ka në plan të ndalet përderisa iu bashkua motrave bukuroshe Gigi e Bella për sfilatën e Alberta Ferrettit.

Koleksioni pranverë/verë 2019 i Ferrettit u shfaq ditën e mërkurë gjatë Javës së Modës në Milano. Supermodelueset treguan fizikun e tyre fantastik të veshura në fustane të errëta si dhe kombinime të dukjeve të thjeshta për daljet ditën.



## Dua Lipa me imazhe atraktive nga Tajvani

**S**uperylli shqiptar, Dua Lipa, ka publikuar një sërë fotografish atraktive në rrjetet sociale. Bukuroshja shqiptare po qëndron në Tajvan ku po vazhdon turneun aziatik.

Këngëtarja, pasi pati telashe në koncertin në Shanghai, ku policia rrahu adhuruesit e saj, Dua ka kaluar më mirë në Tajvan. Ajo ka pozuar mbi çatinë e një ndërtese të lartë në shtetin aziatik.

## Bieberi mahnit të dashurën, nxjerr kitarën dhe bën muzikë në rrugë



**J**ustin Bieber dhe Hailey Baldwin kanë vazhduar turneun e tyre shëtitës në Londër dhe në këtë mënyrë i kanë shkelur të gjitha vendet turistike që i ofron kryeqyteti anglez. Hyde Park, The London Eye dhe Buckingham Palace janë vetëm disa prej vendeve të cilat i ka vizituar çifti i

famshëm. Derisa vazhdonin aventurën e tyre, Bieber e ka mahnitur partneren e tij duke e nxjerrë kitarën dhe duke bërë muzikë në rrugë. Siç transmeton "Cosmopolitan.com", ai e ka interpretuar një version të qetë të këngës "Cold Water" para kalimtarëve të rastit.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SASSUOLO - EMPOLI

1

MONACO - NIMES

GG

CHATEAUX - BEZIERS

1

# Feronikeli, gati ta zbresë nga froni Flamurtarin

Mesfushori Albutrint Morina është optimist se skuadra e Feronikelit do të arrijë fitore ndaj Flamurtarit të shtunën në kryeqytet. "Sa i përket Flamurtarit mendoj se do jetë një ndeshje shumë e vështirë për faktin se kjo skuadër po kalon nëpër një formë të mirë, por besoj se kemi potencial për ta marrë rezultatin që dëshirojmë dhe ta rrëzojmë Flamurtarin nga pozita e parë", ka thënë Morina për "Epokën e re"

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 20 SHTATOR** - Skuadra e Feronikelit ka synim të madh në fundjavë. Ajo dëshiron ta zbresë nga pozita e parë skuadrën e Flamurtarit, e cila është befasia e këtij edicioni në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Kuqezinjtë e kryeqytetit kanë grumbulluar 13 pikë nga pesë ndeshjet e zhvilluara dhe janë në pozitën e parë, kurse "Nikli" zë vendin e dytë me dy pikë më pak.

Mesfushori i skuadrës nga Drenasi, Albutrint Morina, të enjten ka thënë se Feronikeli ka potencial për ta mposhtur skuadrën nga kryeqyteti dhe ta zbresë atë edhe nga pozita e liderit të Superligës. "Sa i përket Flamurtarit mendoj se do të jetë një ndeshje shumë e vështirë për faktin se kjo skuadër po kalon nëpër një formë të mirë, por besoj se kemi potencial për ta marrë rezultatin që dëshirojmë dhe ta rrëzojmë Flamurtarin nga pozita e parë", ka thënë Morina për "Epokën e re".

Skuadra e Feronikelit nuk e nisi mirë kampionatin, por me kalimin e ndeshjeve kjo skuadër është këndelur dhe në opinion shihet si favorite në garën për titull, por një nga favoritët është edhe në garën e Kupës. Madje në këtë klub ka pasur edhe ndryshim në shtabin teknik ku u shkarkua strategu nga Shqipëria, Sulejman Starova, e në vend të tij është emëruar Zekrija Ramadani. Mesfushori Morina është i kënaqur me pikët dhe rezultatet e arritur në pesë xhirot e para të këtij edicioni futbollistik. "Duke i ditur objektivat tona për kampion, mendoj se jemi të kënaqur me pikët që i kemi, edhe



pse me pak fat kemi mundur të kemi edhe më shumë pikë të grumbulluara. Tash na mbetet që në çdo ndeshje të jemi të fokusuar dhe ta japim maksimumin për të mos lëshuar gabime sikurse në fillim të

kampionatit", ka deklaruar ai. Skuadra e Feronikelit, prej pesë ndeshjeve të luajtura, ka regjistruar tri fitore dhe dy barazime, me një golaverazh prej tetë golave të shënuara dhe vetëm një të pranuar.

## SHKURT

### Distria Krasniqi pëson humbje nga Daria Bilodid

Distria Krasniqi nuk arriti ta kalojë ukrainasen shtatlartë Daria Bilodid e cila po dominon në kategorinë 48 kilogramë. Krasniqi u mposhtë me një 'waza-ari' në raundin e dytë të Kampionatit Botëror të Xhudos, "Baku 2018". Me një fitore në botëror, Distria fitoi 200 pikë olimpikë për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Nesër (e shtunë) në "Baku 2018" garojnë Akil (-73 kg) dhe Nora Gjakova (-57 kg), kurse Loriana Kuka (-78 kg) garon të martën.

### Dobroshi, trajner i KH Vëllaznimi

Nexhdet Dobroshi është emëruar trajner i ri i skuadrës së hendbollit nga Gjakova, Vëllaznimit. Kryesia e klubit kuqez i ka uruar mirëseardhje dhe suksese trajnerit të ri, kurse ish-trajnerin Benon Brahushi e ka falënderuar për punën e palodhshme që ka bërë si trajner i klubit.

### Gilardino tërhiqet nga futbollit

Pas pensionimit të Andrea Pirlos nga futbollit, një tjetër kampion bote i ka dhënë lamtumirën botës së futbollit. Bëhet fjalë për sulmuesin Alberto Gilardino i cili, sipas "La Gazzetta dello Sport", ka refuzuar të vazhdojë të luajë në Serinë C, duke varur kështu "këpucët në gozhdë". 36-vjeçari ka pasur një karrierë të pasur, ku vihet re aventura e suksesshme te Milani, me të cilin fitoi edhe një Ligë të Kampionëve, kurse në vitin 2006 u shpall kampion i botës me Italinë.

### Komuna e Prishtinës mbështet katër sportistët olimpikë

Komuna e Prishtinës do t'i mbështesë katër sportistët olimpikë të kryeqytetit me nga 100 euro në ciklin olimpik 2017-2020. Kjo është bërë me dije pas takimit që patën drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani (zyrtar) dhe Shasivar Haxhiaj (sekretar), me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti. "Komuna e Prishtinës u pajtua të bëhet bashkëpunëtare për t'i ndihmuar sportistët olimpikë të Prishtinës, me ç'rast për katër sportistët: Alvin Karaqi e Orges Arifi (karate) dhe Dasar Xhambazi e Flaka Pruthi (not), komuna do të ndajë nga 100 euro për çdo muaj, gjatë ciklit olimpik 2017-2020, sportistë këta që marrin shuma më të vogla nga Solidariteti Olimpik", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

## Në renditjen e FIFA-s Shqipëria ngrehet një pozitë, Kosova tri

Prishtinë, 20 shtator - FIFA ka menduar t'i bëjë disa ndryshime për sa i përket renditjes së shteteve, duke mos lëvizur në mënyrë drastike koeficientet ndërkombëtarë. Pavarësisht prej

humbjes ndaj Skocisë, kuqezinjtë i favorizoi fitorja e parë ndaj Izraelit teksa janë ngjitur një pozicion.

Kombëtarja shqiptare aktualisht ndodhet në vendin e 57, duke lënë

mbrapa Slloveninë, Maqedoninë, Egjiptin etj. Rritje për tre vende ka edhe për Përfaqësuesen e Kosovës që e sheh veten në vendin 138 pas barazimit në Azerbajxhan dhe fitores në shtëpi ndaj Ishujve

Faroe. Me ndryshimet e bëra nga FIFA do të duhet një seri e gjatë rezultatesh pozitive apo negative që skuadrat të bëjnë lëvizje të ndjeshme në klasifikimin e ri botëror.





## Ademi dhe Salihu, pjesëmarrës në takimin rajonal të federatave

PRISHINË, 20 SHTATOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, po marrin pjesë në takimin që po marrin pjesë kryetarët dhe sekretarët e përgjithshëm të 14 feder-

atave të futbollit nga i tërë rajoni. Takimi rajonal po mbahet në Bukuresht të Rumanisë. FFK-ja ka njoftuar se po bisedohet për bashkëpunim ndërrajonal, për gjetjen e formave të ndryshme me interes për zhvillimin e fut-

bollit, si dhe për bashkëpunimin me futbollin e grupmoshave, e meqë U-15 ka më pak gara ndërkombëtare, është hedhur ideja për organizimin e një turneu të përbashkët. Ademi dhe Salihu zhvilluan edhe takime të

veçanta me shumë kryetarë federatash, përfshirë edhe Davor Shukerin e Kroacisë, me presidentin e federatës rumune si nikoqire, Razvan Burleanu dhe atë të Turqisë, Yildirim Demiroren.



## Totti: Ronaldo dhe Ibra nuk pranuan ftesën time

ROMË, 20 SHTATOR - Kapiteni legjendar i skuadrës së Romës, Francesco Totti, ka zbuluar një prapaskenë shumë interesante për mediet italiane. Legjenda e Romës pranoi se ka dashur gjithmonë të luajë me Zlatan Ibrahimoviçin, por ai nuk pranoi asnjëherë të vinte në Romë. "Receta për sukses është shumë e thjeshtë: të kesh lojtarët më të mirë në botë në skuadër. Unë gjithmonë kam dashur dhe shpresuar që edhe Roma të kishte dhe t'i ketë lojtarët më të mirë në botë, por në shumicën e rasteve ishte e pamundur", ka thënë Ronaldo. "Jam munduar dhe vetë t'i bindë lojtarët të vijnë. Të gjithë e dinë se me Ronaldon dhe Ibrahimoviçin jemi miq shumë të mirë dhe i kam ngacmuar shpeshherë që të nënshkruajnë me Romën, por ata nuk më dëgjonin. Më kërkonin mua të



shkoja në skuadrat e tyre, por dhe kjo ishte e pamundur. Shpresoj se kjo situatë të ndryshojë, pasi më vjen keq që

një skuadër me kaq shumë emër sa Roma të mos tërheqë futbollistët më të mirë në botë", ka deklaruar Totti.

## Hardeni: Titulli, objektivi ynë kryesor

HOUSTON, 20 SHTATOR - Ylli i skuadrës së Houston Rocketsit, James Harden, pasi fitoi trofeun e MVP-s sezonin e kaluar në NBA, ka deklaruar se tashmë pretendimet për të dhe ekipin e tij janë më të larta. Rocketsi, edhe pse e mbylli sezonin e rregullt në vendin e parë në Perëndim, u mund nga Golden State në finalen e shtatë të "play-off-it, pa pasur mundësi të shpallet kampion në këtë kah të NBA-së dhe të luajë për titullin kampion. Por këtë herë objektivi që i shpëtoi nga duart "mjekrës" është primar për të. "Titulli kampion mbetet objektivi ynë kryesor këtë sezon. Në Perëndim është gjithnjë e vështirë, pasi këtu janë skuadrat më të mira dhe këtë vit rivaliteti do të jetë më i madh, por edhe ne jemi të përgatitur për ta përballuar atë me sukses", ka thënë Harden, 29 vjeç, gjashtë herë pjesëmarrës në "All Star Game". Harden e mbylli sezonin e kaluar me një mesatare prej 30.4 pikësh për ndeshje, një nga më të lartat e historisë së NBA-së, ndaj ai



shpreson që në sezonin e 10 në NBA t'i japë skuadrës së tij titullin kampion, i cili mungon prej 23 vjetësh. "Përbërja e ekipit këtë sezon është edhe më e fortë, sidomos pas ardhjes së

Carmelo Anthony, që i ka dhënë më shumë forcë grupit në mbrojtje dhe në sulm. Unë mendoj se këtë sezon mund të shkojmë deri në fund", ka shtuar James Hardeni.

### SHKURT

#### Veteli: Do të doja disa këshilla nga Schumacheri

Gjashtë gara për t'u zhvilluar deri në fund të këtij kampionati botëror dhe 40 pikë për t'u rikuperuar nga Sebastian Vettel nëse gjermani dëshiron ta bëjë ëndrrën realitet duke fituar titullin botëror me Ferrarin në këtë sezon. Edhe pse mundësitë që Lewis Hamiltoni të humbasë 40 pikë avantazh në 6 gara janë fare minimale, Vettel beson ende te titulli. "E di si fitohet, pasi jam shpallur katër herë kampion bote. Makina jonë është e barabartë me Mercedesin", theksoi ish-piloti i Red Bullit i cili më pas zbuloi edhe atë për të cilën do të kishte nevojë për t'u shpallur kampion. "Do të më pëlqente të merrja disa këshilla nga Michael Schumacheri".

#### Papini: Neymar-Mbappe-Cavani janë egoist

Ish-lojtari i Milanit dhe Bayern Munchenit, Jean-Pierre Papin, ka thënë se Neymari dhe Kylian Mbappe duhet t'i lënë arritjet e tyre personale anash nëse duan ta fitojnë Ligën e Kampionëve. Ai e ka kritikuar edhe sulmuesin Edinson Cavani. "Me PSG-në ata nuk janë heronj, ata janë egoistë. Është një dallim mes yjeve që i shohim jashtë dhe atyre që i kemi këtu në Francë. Kur Neymari luante për Barcelonën, ai kthehej edhe në mbrojtje...", ka thënë Papin, duke shtuar se: "Ata kanë kualitet. Nuk ka problem këtu, mirëpo ata duhet të bashkohen, pastaj të tjerët të përfitojnë nga kualitetet e tyre. Qëllimi kryesor i klubit është fitimi i Ligës së Kampionëve".

#### Casemiro: Ronaldo e meriton 'Topin e Artë'

Të gjithë duan të emërojnë Luka Modriçin si fituesin e "Topit të Artë" në një garë e cila mund të jetë me ish-madrilenin Cristiano Ronaldo. Por, mesfushorët brazilian Casemiro nuk i intereson kjo gjë dhe zgjedh këtë të fundit si fituesin e çmimit më të madh individual. Casemiro u rikthye titullar në ndeshjen e Ligës së Kampionëve dhe u vu re se është lojtar i domosdoshëm për ekipin madrilen. "Unë mendoj se Luka ka qenë shumë i mirë këtë sezon dhe ka bërë gjëra pozitive, por nëse do të ishte për mua, do t'ia jepja Cristiano Ronaldos", ka thënë Casemiro.

#### Reali në garë për De Jongun

Florentino Perez po synon ta rëmbejë Frenkie De Jong para Barcelonës. Sipas "Don Balon", presidenti i Realit është i gatshëm ta bëjë befasinë dhe të drejtojë një ofertë rreth De Jongut. Ajaxi ka raporte tejet të mira me skuadrën e Barcelonës. Gjithashtu, lojtari është shprehur se ka dëshirë të luajë krahas Lionel Messit, mirëpo Perez duket se ka besim për arritjen e një marrëveshje me lojtarin. Synimi i "mbretërve" është ta transferojnë lojtarin gjatë afatit dimëror.

#### Butleri kërkon largimin nga Minnesota

Ylli i Minnesota Timberwolves, Jimmy Butler, ka kërkuar largimin nga skuadra përpara fillimit të sezonit 2018-2019. Sipas medieve amerikane, ekipet të cilat Butleri do ta pranonte transferimin janë Brooklyn Nets, Los Angeles Clippers dhe New York Knicks. Butler u mor në qershorin e 2017-s nga Minnesota, pas një marrëveshjeje me Chicago Bulls. Në sezonin e kaluar ai kishte një mesatare prej 22.2 pikësh, 5.3 topa në tabelë, 4.9 asistime dhe dy topa të vjedhur për ndeshje. Pavarësisht se zhvilloi një sezon të mirë, ka pasur shumë zëra se 29-vjeçari nuk kishte një marrëdhënie të mirë me disa prej lojtarëve kryesorë të Timberwolves.





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec  
Njësia e Personelit / Jedinica za Personal / Personnel Unit



01Nr./br. 2640  
Me datë/dana.20.09.2018  
Rahovec/Orahovac

Form. MAP- SHCK-02  
Obraz. MJU-CSK-02

## SHPALLJE E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucionij/ Komuna e Rahovecit / kërkon të punësoj në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa .  
Institucija / Opština Orahovac želi da regrutuje u Odeljenc za Budžet i Finansije.

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Arkatar ( 1 pozitë )
- Blagajnik ( 1 položaj)

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: A4-G11 / koeficienti i pagës 6.  
Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta: A4-G11/koeficijent plate 6.

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto : AD/160/ JP00034033.

Detyrat dhe përgjegjësitë/ Poslovi i odgovornosti :

[Shënoni saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore/  
(Ukratko i Tačno naznačite osnovne odgovornosti):  
menaxhon dhe mirëmban të gjitha transaksionet e parasë së gatshme në institucion; 25%  
kujdeset për sigurinë e të gjitha parave të gatshme në institucion; 15%  
planifikon dhe kontrollon të gjitha shpenzimet e parasë së gatshme; 15%  
mban evidenca për shpenzimet e parasë së gatshme dhe i sistemon në regjistrator përkatës; 15%  
rishikon raportet, format, dhe të dhënat për saktësinë, plotësinë, dhe përputhshmërinë e tyre lidhur me shpenzimet e parave të gatshme; 15%  
bën barazimin ditor në bankën kompetente; 7%  
kujdeset për ruajtjen dhe arkivimin e bllok dëftesave; 5%  
paraqet raporte punë mujore, periodike dhe vjetore; 2 %  
kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eporit që janë në pajtim me ligjin; 1%  
rukovodi i održava sve prenose novčanih sredstava u instituciji; 25%  
stara se za sigurnost novčanih sredstava u instituciji; 15%  
planira i vrši kontrolu potrošnje svih novčanih troškova; 15%  
vodi evidenciju za potrošnju novčanih sredstava i sistemira u dotični folder; 15%  
proverava izveštaje i podatke da bi potvrdio način potrošnje novčanih sredstava; 15%  
priprema izveštaj sitnih novčanih sredstava, i izveštaj o stanju trezora; 7%  
čuva i ubaciva u arhivu blok paragone (blok potvrde); 5%  
izrađuje mesečni, periodični i godišnji izveštaj o radu -2%  
vrši i ostale dužnosti prema zahtevu starešine, a koje su u skladu sa zakonom – 1%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učešće na regrutaciji/

[Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil  
/ Navedite uslove za učesće u procesu regrutacije po Zakonu o Javnoj Službi]

Kandidati përveç kushteve të lartë shënuar duhet ti plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara sipas ligjit mbi shërbimin civil nr.03/L-149, si dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës, të mos jenë nën hetime penale apo i dënues për vepra penale . Kandidat osim gorenavedenih uslova treba da ispuni i opšte uslove predviđene zakonom o civilnoj službi br. 03/L-149, kao i Kosovskih zakona koji su u primeni , da nije pod krivičnom istragom ili kažnjen zbog krivičnog dela.

Procedurat e konkurrimit/ Postupak konkurisanja/

Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civil ekzistues  
- Navedite ukoliko je procedura za konkurisanje javno objavljena i za javne službenike koji rade u instituciji ili je interna procedura za službenike koji već rade:  
Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues edhe për kandidatët e jashtëm .Postupak konkurisanja je otvoren kako za postojeće civilne službenike tako i za spoljne kandidate .

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanja koje se zahteva/

[Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/ Upišite realno potrebno obrazovanje za obavljanje ovog posla]

Përgatitja shkollore : Diplom bachelor-drejtimi ekonomi, banka, financa, menaxhment  
Školska sprema: Bachelor Diplomu- smer ekonomije, banka, financije, menadžment

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

[Përshkruaj aftësitë, përvojën dhe vetitë personale të cilat janë të kërkuara dhe të cilat mund të qënë të dëshiruara. Këto duhet të kenë lidhje me punën dhe të jenë objektive/Opišite sposobnosti, iskustvo i licne osobine koje se zahtevaju kao i one koje su poželjne. One treba da su u vezi sa radon i da su objektivne ]:

Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të njohur teknike ose administrative

Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara  
Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët

Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik  
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)  
Diplom bachelor-drejtimi ekonomi, banka, financa, menaxhment

Së paku katër (4) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative  
Poznavanje standardnih administrativno/tehničkih postupaka u nekoj poznatoj tehničkoj ili administrativnoj oblasti

Sposobnost da radi samovoljno u okviru određenih planova i postupaka,

Dobre sposobnosti komunikacije, uključujući sposobnost tumačenja informacija, uputstva ostalim,

Sposobnost nadzora i koordinacije rada osoblja na administrativnom i tehničkom nivou,

Sposobnost rada kompjuterskim aplikacijama programa (Word, Excel, Power Point, Access)

Najmanje 4 godinac radnog iskustva dotičnog tehničko ili administrativne oblasti

Dokumentet që kërkohen:

- Diplomë
- Diplomu
- Vërtetimi që nuk është nën hetime
- Potvrda da nije pod istragom
- CV-ja
- CV
- Çertifikata e lindjes
- Izvod Rođenja
- Kopja e letërnjoftimit
- Kopija lične karte
- Dëshmi e përvojës së punës
- Dokaz o radnom iskustvu

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin/Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:

[Shënoni një përshkrim të shkurtë të përzgjedhjes dhe të rregulloreve ekzistuese që rregullojnë rekrutimin / Navedite kratak opis izbora i postojećih pravilnika koji regulišu zapošljavanje]

Kandidatët e sukseshëm do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 .

Uspešni kandidati uputiće se na pismenom testiranju i usmenom intervjuisanju. Izbor će se izvršiti na osnovu zakona o Civilnoj Službi i Pravilnika za Regrutaciju br. 02/2010

Kohëzgjatja e emërimit/Vremenski rok imenovanja:

[Shënoni nëse emërimi është me kohë të caktuar ose me kohë të pacaktuar dhe periudhën e kohëzgjatjes/Naznačite ako imenovanje je na određeno vreme ili na neodređeno vremenski rok]:

Në kohë të pacaktuar.Na neodređeno vreme.

Data e mbylljes së konkursit / Krajni rok konkursa

:

[Shënoni kohëzgjatjen e konkursit dhe datën e mbylljes/Naznačite vremenski rok trajanja konkursa i krajni rok].

Afati i Konkursit është 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik. Rok za konkurisanje je 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja.

Paraqitja e kërkesave/Prijava zahteva-Podnošenje zahteva/

[Shënoni vendin ku dhe kur mund të merren formularët e aplikacionit si dhe vendin ku duhet të dorëzohen dhe adresa e plotë e institucionit pranues  
/ Navedite kako i gde se mogu dobiti obrazci za konkurisanje i mesto gde može predati i tačna adresa institucije]

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e pranimit në objektin e Komunës së Rahovecit Adresa:Rruga,„Xhelal Hajda-Toni" pr. Rahovec.Aplikacije se mogu podići i dostaviti pri prijemnoj kancelariji u objektu Opština Orahovac.Adresa: Ul." Xhelal Hajda-Toni" b.b Orahovac.

Kërkesat specifike / Specifični zahtevi

[Shënoni nëse ka ndonjë kërkesë specifike shëndetësore ose fizike për kryerjen e detyrave të punës, përfshirë kërkesën për vlerësim mjekësor  
/ Navedite ako ima neki specifičan zahtev zdravstvene ili fizike prirode za izvršavanje radnih obaveza, sa zahtevom za mišljenje lekara].

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/Kosovska javnana služba je u službi svih ljudi na Kosovu, i prima aplikacije muškaraca i žena iz svih Kosovskih zajednica  
“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

–Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljani proporcionalno u organima Javne službe na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno i Čl. 11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.

